



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 610 Akti

Nr. 743 Vendim
Tiranë, më 19.3.2024

V E N D I M

Trupi gjykues nr. 2 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici	Kryesues
Valbona Sanxhaktari	Relatore
Firdes Shuli	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Elda Faruku, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në datën 13.3.2024, ora 10:00, zhvilloi në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Gentian Hamiti**, me detyrë gjyqtar, aktualisht ushtron detyrën në Gjykatën Administrative të Apelit.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Gentian Hamiti i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio* në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për shkak të funksionit të tij si gjyqtar në Gjykatën

Administrative të Shkallës së Parë Tiranë¹. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.12.2020, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 2.

2. Me vendimin nr. 1, datë 15.1.2021, të trupit gjykues, është deklaruar lidhur me konfliktin e interesit nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues, është vendosur fillimi i hetimit administrativ kryesisht dhe është caktuar kryesues i trupit gjykues komisioneri Olsi Komici.

3. Në vijim, në datën 22.1.2021, subjekti i rivlerësimit, pasi është njoftuar mbi përbërjen e trupit gjykues, ka deklaruar se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupit gjykues.

4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ). Subjekti është kontaktuar nëpërmjet adresës elektronike, deklaruar për hetim të mëtejshëm, ku iu dërgua pyetëtori standard i përgatitur nga Komisioni, si dhe pyetje të tjera gjatë hetimit administrativ.

5. Trupi gjykues, i mbledhur në datën 22.2.2024, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, pasi u njoh me raportin mbi rezultatet e hetimit dhe rekomandimin e relatores së çështjes, vendosi: (a) përfundimin e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit Gentian Hamiti, në përputhje me pikën 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; dhe vlerësimi i aftësive profesionale; (b) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, si dhe ta ftojë atë për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative; (c) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera, thirrjen e dëshmitarit, afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta, si dhe të paraqesë parashtrimet e tij lidhur me rezultatet e hetimit.

6. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e administruara në dosjen e hetimit duke marrë një kopje të saj dhe brenda afatit të caktuar nga Komisioni paraqiti shpjegime e prova lidhur me rezultatet e hetimit.

7. Më tej, trupi gjykues, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, ftoi subjektin e rivlerësimit Gentian Hamiti për t’u paraqitur në seancën dëgjimore të datës 13.3.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë.

8. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 13.3.2024, ora 10:00, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova. Subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm në këtë seancë dëgjimore.

9. Gjatë kësaj seance dëgjimore, subjekti i rivlerësimit parashtrroi qëndrimin e tij lidhur me rezultatet e hetimit, në përfundim të së cilës ai kërkoi konfirmimin në detyrë.

10. Trupi gjykues, pasi diskutoi lidhur me shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit referuar rezultateve të hetimit, në përfundim vendosi të mbyllë hetimin administrativ dhe të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Gentian Hamiti.

¹ Aktualisht, sipas skemës së delegimit të gjyqtarëve, me vendimin nr. ***, datë 12.10.2023, të KLGJ-së, subjekti i rivlerësimit Gentian Hamiti është caktuar për të gjykuar pranë Gjykatës Administrative të Apelit deri në datën 23.10.2026.

II. PROCESI I RIVLERËSIMIT

11. Procesi i rivlerësimit, i cili kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Anëtarët e Komisionit hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Ata kanë të drejtë të çmojnë sipas bindjes së tyre të brendshme çdo *indicie* në veçanti apo në tërësi lidhur me faktet apo rrethanat e çështjes.

12. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi të pabazuar në përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse².

13. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja dhe provat e dorëzuara nga subjekti pranë këtij institucioni në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja, së bashku me dokumentacionin shoqërues, informacionin e përditësuar;
- c) raportin e dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja, së bashku me dokumentacionin shoqërues;
- d) dokumentacionin shkresor të administruar nga organet publike dhe/ose private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- e) deklaratimet e vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit shkresor, elektronik dhe gjatë seancës dëgjimore;
- f) deklaratimet e vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit elektronik;
- g) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, si dhe provat e paraqitura në përfundim të hetimit kryesisht;
- h) denoncime/ankesa nga publiku.

14. Lidhur me qëndrimin e subjektit të rivlerësimit Gentian Hamiti, trupi gjykues vëren se ai ka qenë bashkëpunues gjatë procesit të rivlerësimit në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ ai ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni.

A. VLERËSIMI I PASURISË

15. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit në ILDKPKI së bashku me dokumentacionin provues. Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja në raportin e saj ka konkluduar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

² Vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese: “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga KPK-ja, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi”.

16. Komisioni kreu verifikimin dhe analizoi Deklaratën e Pasurisë *Vetting* dhe deklaratat periodike vjetore të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, nga të cilat rezultoi sa vijon.

17. Subjekti i rivlerësimit është martuar në vitin 2013 me znj. Armida Moçka, me funksion prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e cila i është nënshtruar gjithashtu procesit të rivlerësimit kalimtar nga Komisioni³.

18. Lidhur me adresat e banimit

Lidhur me adresat e banimit ndër vite, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në DPV, pyetësor dhe deklaratën *Vetting*, rezulton:

i) Në DPV-të e viteve 2007, 2010 dhe 2011 subjekti i rivlerësimit, krahas adresës ku rezulton i regjistruar në gjendjen civile, deklaroi si adresë edhe lagjen “****”, në Vlorë.

ii) Në DPV-të e viteve 2008 dhe 2009 deklaroi si adresë lagjen “****”, në Vlorë.

iii) Në pyetësorin standard, prej emërimit në detyrë, datë 5.10.2007, deri në dhjetor 2011, ka deklaruar adresë banimi me qira në qytetin e Vlorës, në lagjen “****”, apartament garsonierë, në pronësi të shtetasit D. L. dhe ka paguar qira 5.000 (pesë mijë) lekë/muaj.

iv) Për periudhën janar 2012 subjekti ka deklaruar se ka jetuar në Vlorë, lagjja “****”, rruga “****”, në apartamentin e blerë me Kontratën e Porosisë së datës 4.5.2011 nga personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe familja e saj.

v) Prej datës 4.11.2013 e në vijim jeton me bashkëshorten e dy fëmijët në apartamentin e marrë me qira në rrugën “****”, Tiranë, me çmim 20.000 (njëzet mijë) lekë/muaj, deklaruar prej tij në deklaratën *Vetting*.

Komisioni hetoi⁴ në lidhje me ekzistencën e një konflikti të mundshëm interesi ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit D. L., ku nga hetimi nuk rezultuan të dhëna të tilla⁵.

Lidhur me apartamentin me qira në rrugën “****”, Tiranë, nga verifikimet rezultuar se: Faturat e konsumimit të energjisë elektrike, si dhe të konsumimit të ujit në banesën në të cilën jetojmë me qira, i paguan subjekti i rivlerësimit në cilësinë e qiramarrësit. Nga dokumentacioni i administruar vërehet se librezat janë në emër të qiradhënësit (pronarit të pasurisë). Nga verifikimet nuk rezultuan rrethana të ekzistencës së ndonjë konflikti interesi të mundshëm për shkak të funksionit të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij me qiradhënësin.

18.1 Deri në këtë fazë të hetimit duket se ka mospërputhje të adresave të banimit, sipas deklaratave periodike vjetore 2007 – 2011 dhe deklarimeve në pyetësorin standard, duke i kërkuar subjektit të rivlerësimit i është të japë shpjegime lidhur me këtë konstatim.

18.2 Në prapësimet e tij, në vijim të rezultateve të hetimit, ai shpjegon: *“Kam jetuar tek i njëjti apartament, me të njëjtin pronar. Për sa i përket adresës së deklaruar lagjja “****”, Vlorë, kjo adresë e deklaruar prej meje ka qenë e lidhur me atë të vendit të punës, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Më pas kam deklaruar si adresë lagjen “****”, ndërkohë që siç jam informuar më vonë, adresa e saktë ku unë banoja quhej lagjja “****”, e cila është kufitare me lagjen “****”. Nuk kam pasur për qëllim për të dhënë një informacion të pasaktë, ndoshta ka qenë një gabim njerëzor pasqyrimi i dy adresave të ndryshme për të njëjtin apartament, gabim dhe konfuzion, i cili ka buruar nga mosnjohja mirë e adresarit të Bashkisë Vlorë”.*

18.3 Në përfundim, trupi gjykues, pasi vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në raport me faktet dhe rrethanat, i konsideron ato të plota dhe bindëse duke mos konstatuar problematika për hetime/verifikime të mëtejshme.

³ Shihni vendimin nr. 605/2022, datë 21.12.2022, të Komisionit, subjekti i rivlerësimit A. Hamiti.

⁴ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 12.12.2023 (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier) dhe shkresën nr. *** prot., datë 12.12.2023 (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë), dosja e hetimit.

⁵ Shihni shkresat nr. *** prot., datë 26.12.2023 dhe nr. *** prot., datë 15.1.2024, dosja e hetimit.

19. Të ardhura në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) lekë, përfituar përpara vitit 2005 nga ushtrimi i aktivitetit privat “Fast food”, së bashku me pjesëtarë të familjes (vëllai), shumë e cila është konsumuar ndër vite. Në lidhje me këtë deklaram, subjekti i ka bashkëlidhur Deklaratës *Vetting* ekstraktin historik të regjistrimit tregtar datë 12.10.2016⁶, për personin fizik “F. H.”, datë regjistrimi 2.2.1998, me vendndodhje në Delvinë, objekti “Bar-kafe”, si dhe vërtetimin nga Bashkia Delvinë⁷, sipas të cilit personi fizik “F. H.”, me NIPT ***, ka filluar veprimtarinë e biznesit në datën 15.2.1998 dhe ka likuiduar detyrimet tatimore të pushtetit lokal në mënyrë të rregullt për çdo vit.

19.1 Në deklaratën para fillimit të detyrës, viti 2007, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 1.300.000 (një milion e treqind mijë) lekë, si shumë e përfituar nga shitja e truallit dhe aktiviteti tregtar “Fast food”.

19.2 Komisioni, pasi verifikoi dokumentacionin e administruar, arriti në konkluzionin se për të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në Deklaratën *Vetting*, të përfituara nga aktiviteti privat i të vëllait përpara vitit 2005, nuk provohej burimi i ligjshëm sipas kërkesave të nenit D/3 të Aneksit të Kushtetutës.

19.3 Në paraqitjen e prapësimeve të tij, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se: *“Vëllai ka qenë i regjistruar prej vitit 1998 si person fizik me objekt veprimtari “Bar-kafe” dhe “Fast food”. Biznesi ka qenë i licencuar si person fizik në emrin e vëllait tim F. H., provuar nga ekstrakti historik i regjistrimit tregtar datë 12.10.2016, për personin fizik “F. H.”, datë regjistrimi 2.2.1998, me vendndodhje në Delvinë, objekti “Bar-kafe” dhe “Fast food”, si dhe vërtetimi nr. *** prot., datë 12.10.2016, nga Bashkia Delvinë, sipas të cilit personi fizik “F. H.”, me NIPT ***, ka filluar veprimtarinë e biznesit në datën 15.2.1998 dhe ka likuiduar detyrimet tatimore, si dhe ato të pushtetit vendor në mënyrë të rregullt për çdo vit. Unë kam suportuar vëllain në këtë biznes, duke e ndihmuar atë në ditët që ndodhesha pranë familjes, pasi në vitin 1998 unë kisha nisur studimet në qytetin e Tiranës dhe pranë familjes vija rrallëherë. Për shkak të marrëdhënies së posaçme familjare dhe suportit modest që i kisha dhënë vëllait, ai ka vlerësuar që të më japë shumën 500.000 (pesëqind mijë) lekë, në momentin e emërimit si gjyqtar stazhier, shumë të cilën e kam deklaruar në deklaratën përpara fillimit të detyrës si gjyqtar. Këtë fakt e provoj me Deklaratën Noteriale të datës 4.3.2024 të z. F. H., sipas së cilës ai deklaroi se: “Në datën 2.2.1998 është regjistruar si person fizik “Bar-kafe” “Fast food”, me NIPT ***, në adresën lagjja “***”, Delvinë. Këtë aktivitet e kam ushtruar deri në datën 24.7.2020, datë në të cilën është bërë çregjistrimi i subjektit. Në aktivitetin tim privat, gjatë pushimeve të verës, më ka ndihmuar edhe vëllai im Gentian Hamiti, i datëlindjes 21.9.1976, titullar i dokumentit të identitetit nr. *** dhe nr. personal ***. Kur u emërua gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, vlerësova t’i jap shumën 500.000 (pesëqind mijë) lekë për arsye të marrëdhënies familjare që kemi pasur dhe të ndihmës që më ka dhënë në aktivitetin tim privat më parë.*

Në lidhje me këtë shumë monetare të deklaruar prej meje, kjo shumë është konsumuar për nevoja jetësore personale dhe nuk ka shërbyer për të krijuar ndonjë pasuri të luajtshme apo të paluajtshme”.

19.4 Në përfundim, trupi gjykues, pasi vlerësoi qëndrimin e subjektit së bashku me dokumentacionin e paraqitur prej tij në cilësinë e provave, si dhe në raport të drejtë me deklaramet çmon se rezultoni e provuar ekzistenca e një aktiviteti tregtar të licencuar nga vëllai i subjektit të rivlerësimit e me një qarkullim të deklaruar për të cilat janë paguar edhe detyrimet tatimore sipas legjislacionit të kohës (e provuar me dokumentacion).

Marrëdhënia mes vëllezërve dhe ekzistenca e këtij aktiviteti tregtar (si biznes familjar) rezultoni e deklaruar në DPV dhe nëpërmjet deklarameve gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar e, megjithëse nuk rezultoni e provuar ndonjë marrëdhënie konkrete punësimi, në legjislacionin e kohës personat fizikë kishin të drejtë të punësonin familjarë ose të afërt në biznesin e tyre, ndaj

⁶ Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁷ Vërtetimi nr. *** prot., datë 12.10.2016, dosja e ILDKPKI-së.

ky deklaram është i besueshëm e duhet pranuar si deklaram i saktë e i vërtetë nga ana e subjektit të rivlerësimit.

Për sa i përket efektit financiar, në analizën e Komisionit bërë nga njësia e shërbimit ligjor, rezulton se shuma nuk afekton apo justifikon krijimin e ndonjë pasurie, ndaj nuk ka një vlerë relevante.

Në këtë vlerësim, trupi gjykues mbajti në konsideratë faktet se të ardhurat janë krijuar përpara fillimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit, biznesi ishte i licencuar dhe funksional si biznes familjar e se nuk janë vërejtur rrethana, të cilat mund të përbëjnë *indicie* për hetim të mëtejshëm në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar.

20. Të ardhurat në shumën 800.000 (tetëqind mijë) lekë, të përfituara nga shitja e truallit me sip. 300 m², sipas Kontratës së Shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.2.2008. Pjesa takuese: 100%.

a) Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës së vitit 2005 (si OPGJ), subjekti i rivlerësimit deklaroi se: *“Në emrin tim ekziston një sipërfaqe truall prej 300 m², mbi të cilën është ndërtuar një godinë 5-katëshe. Trualli është në të vërtetë i të vëllait dhe djalit të xhaxhait, të cilët do të regjistrojnë këtë pasuri në emër të tyre në momentin e hipotekimit të objektit. Ky truall është blerë nga Zyra e Përmbartimit Sarandë, ku ekziston edhe kontrata e shitjes”. Vlera e pasurisë deklarohet 215.000 (dyqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë, pjesë takuese 0%, krijuar në dhjetor 2002.*

b) Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës si magjistrat, viti 2007 (data e emërimit 5.10.2007), subjekti i rivlerësimit deklaroi gjendje *cash* në shumën 1.300.000 (një milion e treqind mijë) lekë, e përfituar prej shitjes së një truallit me kontratë shitblerjeje, si dhe nga aktiviteti i biznesit të vogël “Fast food”, i ushtruar së bashku me pjesëtarë të familjes.

20.1 Lidhur me verifikimin e kësaj situatë, referuar akteve të administruara nga regjistri hipotekor⁸, rezultoi se:

i) *Subjekti i rivlerësimit e ka blerë pasurinë truall me sip. 300 m², në Delvinë, vlera 215.000 (dyqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë me Kontratë Shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.12.2002, me palë shitëse Zyra e Përmbartimit Sarandë.*

ii) *Me vërtetim nr. ***, datë 23.12.2002, nga regjistri hipotekor, pasuria truall me sip. 300 m², në Delvinë, figuron e regjistruar në pronësi të shtetasit Gentian Hamiti.*

iii) *Me Kontratë Shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.2.2008, subjekti i rivlerësimit i ka shitur truallin me sip. 300 m², në vlerën 800.000 (tetëqind mijë) lekë, shtetasve A. H. (djali i xhaxhait) dhe F. H. (vëllai).*

20.2 Në pyetësorin standard, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka përfituar të ardhura nga shitja e truallit prej 300 m², sipas Kontratës së Shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.2.2008, me çmim 800.000 (tetëqind mijë) lekë, për të cilën është paguar tatimi i mbajtur në burim në shumën 87.750 (tetëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë.

20.3 I pyetur nga Komisioni⁹ në vijim të verifikimeve subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se pasuria e përshkruar në deklaratën para fillimit të detyrës si OPGJ në Sarandë është e njëjta e deklaruar edhe në Deklaratën Vetting. Ai shpjegoi: *“Pasuria është blerë nëpërmjet ankandit të shpallur nga Zyra Përmbartimore Sarandë nga data 26.11.2002 deri më 10.12.2002, përkundrejt çmimit të shitjes 215.000 (dyqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë. Pas shpalljes fitues nga ankandi, midis Zyrës Përmbartimore Sarandë, në cilësinë e shitësit, dhe z. Gentian Hamiti, në cilësinë e blerësit, është lidhur Kontrata e Shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.12.2002, për truallin me sip. 300 m², të ndodhur në qytetin e Delvinës, me çmimin e shitjes në shumën*

⁸ Aneksi nr. ***, dosja e ILDKPKI-së.

⁹ Shihni pyetësorin e datës datës 3.3.2023 dhe 24.4.2023.

215.000 (dyqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë, ku kam qenë thjesht një palë blerëse, me status individ, pasi nuk kam pasur asnjë pozicion zyrtar/publik. Në datën 23.12.2002, kontrata është regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë.

Në lidhje me këtë pasuri të paluajtshme me sip. 300 m², të llojit truall, i ndodhur në lagjen “***”, Delvinë, midis meje në cilësinë e pronarit të truallit dhe z. F. H. dhe z. A. H., në cilësinë e investitorëve, është lidhur Kontrata e Sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.5.2004. Në bazë të kësaj kontrate sipërmarrjeje (investimi), pala pronare e truallit (subjekti i rivlerësimit) kundrejt përfitimit në vlerë të çmimit të truallit (sipas pikës B 2), vë në dispozicion të palës sipërmarrëse, duke i kaluar edhe të drejtën e pronësisë, truallin e mësipërm me sip. 300 m², ku pala sipërmarrëse merr përsipër ndërtimin e një objekti, lokal + banesë, sipas lejes së ndërtimit të miratuar nga organet kompetente. Palët bien dakord që z. Gentian Hamiti, në cilësinë e pronarit të truallit, duke vënë truallin e mësipërm në dispozicion dhe duke i kaluar investitorit (sipërmarrësit) dhe të drejtën e pronësisë së truallit përfiton vetëm (vlerën) çmimin e truallit, i përcaktuar nga palët në shumën 800.000 (tetëqind mijë) lekë (të reja). Shumën e mësipërme që përbën vlerën (çmimin) e plotë të truallit.

Nepërmjet vendimit nr. ***, datë 26.3.2004, të KRT-së Bashkia Delvinë dhe lejes së ndërtimit nr. ***, datë 30.4.2004, është ndërtuar objekti lokal + banesë (1+5), mbi sipërfaqen 300 m², i llojit truall, lagjen “****”, në Bashkinë Delvinë, me investitorë z. F. H. dhe z. A. H..

Bazuar në Lejen e Shfrytëzimit të objektit datë 25.8.2005 dhe Akt Kolaudimit datë 17.8.2006, është bërë regjistrimi i këtij objekti pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë, në emër të z. F. H. dhe z. A. H.. Ky regjistrim është bërë në datën 13.12.2005. Për këtë është lëshuar dhe vërtetimi nga dokumenti hipotekor datë 21.2.2006, sipas të cilit: në emër të z. F. H. dhe z. A. H. figuron e regjistruar pasuria me nr. ***, objekti: lokal dhe banesë, e përbërë nga lokali nëntokë dhe pesë kate mbi tokë, e ndodhur në zonën kadastrale ***, me sip. 204.14 m², lagjja “****”, Delvinë.

Në mbështetje të detyrimeve, të cilat buronin nga Kontrata e Sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.5.2004, midis meje në cilësinë e pronarit të pasurisë së paluajtshme me sipërfaqe 300 m², të llojit truall, dhe z. F. H. dhe z. A. H., në cilësinë e investitorëve të objektit lokal + banesë (1+5), në lagjen “****”, Bashkia Delvinë, është lidhur Kontrata e Shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.2.2008. Kjo kontratë shitjeje ka pasur për palë të saj: shitës Gentian Hamiti dhe blerës z. F. H. dhe z. A. H..

Pas lidhjes së Kontratës së Shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.2.2008, blerësit e pasurisë së paluajtshme me sip. 300 m², të llojit truall, të ndodhur në zonën kadastrale nr. ***, Lagja “****”, Delvinë, kanë aplikuar për regjistrimin e saj pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë, duke bërë kështu edhe regjistrimin e kësaj sipërfaqe trualli prej 300 m², në emër të tyre, krahas regjistrimit të mëparshëm që është bërë në datën 13.12.2005, po në emër të tyre të objektit lokal + banesë (1+5), në lagjen “****”, Bashkia Delvinë. Nga informacioni që kam marr nga vëllai im F. H. (një prej investitorëve të këtij objekti lokal + banesë 1+5), aktualisht një pjesë e ndërtimit figuron i regjistruar në emër të investitorëve të saj, ndërsa sipërfaqja më e madhe e këtij objekti, është shitur tek persona të tretë”.

20.4 Komisioni hetoi¹⁰ lidhur me këtë pasuri, nga ku rezultoi se:

a) Me vendimin nr. ***, datë 30.4.2004, të KRRT-së Bashkia Delvinë, është miratuar leja e ndërtimit për objektin “Lokal dhe banesë vetjake (1+5)”, i cili do të financohet nga shtetasit F. dhe A. H., me shesh ndërtimi pasurinë 300 m², në pronësi të subjektit të rivlerësimit.

b) Në datën 10.5.2004 është nënshkruar Kontrata e Sipërmarrjes (për ndërtim objekti) nr. *** rep., nr. *** kol., midis palës pronare të truallit, subjektit të rivlerësimit Gentian Hamiti dhe palës sipërmarrëse A. H. dhe F. H.. Palët kanë dakordësuar se z. Gentian Hamiti, në cilësinë e

¹⁰ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 9.6.2023, Bashkia Delvinë, shkresën nr. *** prot., datë 26.6.2023, DVASHK Sarandë.

pronarit të truallit, i kalon investitorit (sipërmarrësit) të drejtën e pronësisë së truallit, duke përfutur vetëm vlerën e çmimit të truallit, i përcaktuar nga palët në shumën 800.000 (tetëqind mijë) lekë (të rinj). Palët konfirmojnë para noterit se sipërmarrësi ia ka dorëzuar pronarit të truallit jashtë zyrës noteriale shumën e përcaktuar, e cila përbën edhe vlerën e plotë të truallit. Me marrjen e shumës së mësipërme, pala pronare e truallit e ka humbur të drejtën e pronësisë mbi truallin duke deklaruar se me nënshkrimin e kësaj kontrate nuk ka asnjë pretendim pronësie mbi truallin.

c) Në datën 11.2.2008, me Kontratë Shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.2.2008, subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar për shitjen e truallit me sip. 300 m², në vlerën 800.000 (tetëqind mijë) lekë, me palë blerëse A. H. (djali i xhaxhait) dhe F. H. (i vëllai).

d) Në datën 14.12.2009, subjekti i rivlerësimit dhe shtetasit F. H. dhe A. H. kanë nënshkruar Deklaratën Noteriale nr. *** rep., datë 14.12.2009, në përmbajtje të së cilës deklarohet: *“Palët mes tyre kanë lidhur Kontratën e Sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.5.2004, por, meqenëse në datën 11.2.2008 është lidhur Kontrata nr. *** rep., nr. *** kol., për shitjen e truallit, ata dakordësojnë mes tyre të prishin Kontratën e Sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.5.2004”.*

20.5 Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar dhe përgjigjes së subjektit të rivlerësimit, duket se shitja e truallit nga ana e tij është realizuar sipas Kontratës së Sipërmarrjes datë 10.5.2004 sepse, referuar deklaratës së pasurisë para fillimit të detyrës si gjyqtar (DPV-ja e vitit 2007), në seksionin “Angazhime dhe veprimtari private/publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre”, subjekti i rivlerësimit deklaroi: *“Gjendje cash në shumën 1.300.000 (një milion e treqind mijë) lekë, e përfutur prej shitjes së një trualli me kontratë shitblerje, si dhe nga aktiviteti i biznesit të vogël “Fast food”.* Në DPV-në e vitit 2008, subjekti i rivlerësimit nuk deklaroi të ardhurat nga shitja e truallit, sipas Kontratës së Shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.2.2008.

20.6 Referuar rekomandimit të vëzhguesit ndërkombëtar¹¹, i cili u gjet me vend, Komisioni hetoi¹² lidhur me procese të ndryshme gjyqësore apo situata të mundshme të konfliktit të interesit për këtë pronë, nga ku rezultoi se¹³ në periudhën kur subjekti i rivlerësimit ka qenë pronar i kësaj pasurie janë shqyrtuar dy çështje gjyqësore:

i) Çështja civile me palë paditëse J. Zh., i paditur Gentian Hamiti; person i tretë Zyra Përmbartimore Sarandë dhe shtetasi S.C..

ii) Çështja civile me palë paditëse O.Dh., i paditur Gentian Hamiti; me objekt “Pushim cenim pronësie”.

20.7 Lidhur me çështjen e parë ka rezultuar se:

a) Me vendimin nr. ***, datë 5.5.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, është vendosur “Rrëzimi i kërkesëpadisë, si i pabazuar në ligj e në prova”.

b) Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Gjyrokastër paditësi J. Zh., e cila, me vendimin nr. ***, datë 16.11.2004, ka vendosur “Pranimin e padisë. Anulimin e veprimeve përmbartimore. Ankand për shitjen e truallit të datës 10.12.2002 të Zyrës së Përmbartimit Sarandë”.

c) I padituri Gentian Hamiti paraqiti rekurs në Gjykatën e Lartë, ku në datën 16.12.2005 u vendos mospranimi i rekursit me vendimin nr. ***.

¹¹ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 19.5.2023, të ONM-së dhe shkresën nr. *** prot., datë 12.5.2023, të Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.

¹² Shihni shkresat nr. *** prot., datë 1.6.2023 dhe nr. *** prot., datë 20.6.2023, dosja e hetimit.

¹³ Shihni shkresat nr. *** prot., datë 14.6.2023 dhe nr. *** prot., datë 6.7.2023, dosja e hetimit.

20.8 Lidhur me çështjen e dytë, ka rezultuar se:

a) Padiësja pretendon se i padituri ka filluar ndërtimin e një objekti pa leje ndërtimi mbi truallin e saj dhe kërkon pushimin e cenimit të pronësisë. Sipas mendimit të ekspertit, midis pasurive ka mbivendosje me 39 m². Me vendimin nr. ***, datë 17.11.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, është vendosur “Rrëzimi i kërkesëpadiës së padiësës, si i pabazuar në ligj e në prova.

b) Kundër këtij vendimi, padiësja O. Dh. ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, e cila, pasi ka administruar gjatë gjykimit edhe vendimin nr. ***, datë 16.11.2004, të po kësaj gjykate, ka vendosur me vendimin nr. ***, datë 1.2.2005, “Ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 17.11.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, pranimin e padisë dhe detyrimin e të paditurit të pushojë cenimin e pronësisë”.

c) Në datën 15.2.2005, i padituri Gentian Hamiti ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, ndërsa padiësja O. Dh. ka paraqitur kundër rekurs, me arsyetimin se rekursi nuk ka shkaqe ligjore për pranim.

d) Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. ***, datë 8.6.2006, ka vendosur prishjen e vendimit nr. ***, datë 17.11.2004 dhe vendimin nr. ***, datë 1.2.2005, për shkak të krijimit të rrethanave të reja lidhur me ndërgjyqësinë (pala e paditur Gentian Hamiti nuk është pronar i pasurisë truall).

20.9 Bazuar në dokumentacionin e administruar dhe në deklaratimet e subjektit gjatë hetimit, duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i saktë. Sa më sipër, Komisioni i kërkoj subjektit të parashtojë shpjegimet e tij lidhur me konstatimet e Komisionit.

20.10 Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: *“Dua të sqaroj se në deklaratën para fillimit të detyrës, datë e dorëzimit 1.6.2005, si oficer i policisë gjyqësore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë, kam deklaruar se në emrin tim ekziston një sipërfaqe truall prej 300 m², mbi të cilën është ndërtuar një godinë 5-katëshe, por në të vërtetë është e vëllait tim dhe djalit të xhaxhait, të cilën do ta hedhin në emër të tyre në momentin e hipotekimit të objektit. E ardhura prej 800.000 (tetëqind mijë) lekësh, e cila përbën çmimin e shitjes sipas Kontratës së Shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.2.2008, është krijuar/përfituar në datën 11.2.2008 dhe jo në datën 10.5.2004, në të cilën është lidhur Kontrata e Sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.5.2004. Siç konstatohet kjo kontratë shitjeje mban datë 11.2.2008, ndërsa formulari i deklaratës së interesave private përpara fillimit të detyrës është dorëzuar në muajin mars të vitit 2008, pra pas datës së lidhjes së kontratës së shitjes.*

Megjenëse e zotëroja këtë të ardhur [shumën 800.000 (tetëqind mijë) lekë] të krijuar para dorëzimit të formularit të deklaratës së interesave private para fillimit të detyrës, është vlerësuar prej meje të pasqyrohej në këtë formular. Është një lapsus në deklaram, gabimisht është deklaruar në deklaratën e vitit 2007, por realisht është një e ardhur e vitit 2008.

*I njëjti përshkrim është pasqyruar edhe në Deklaratën Vetting, si e ardhur e përfituar nga Kontrata e Shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.2.2008. Po kështu, në pyetësinorin standard kam deklaruar se kam përfituar të ardhura nga shitja e truallit prej 300 m², sipas Kontratës së Shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.2.2008, me çmim 800.000 (tetëqind mijë) lekë, për të cilën është paguar tatimi i mbajtur në burim në shumën 87.750 (tetëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë. Të tria përshkrimet përputhen me njëra-tjetrën. Kërkoj mirëkuptimin Tuaj, pasi ky ka qenë edhe formulari i parë i plotësuar prej meje në cilësinë e gjyqtarit dhe, për këtë shkak, ky deklaram i pasaktë nuk ka qenë i qëllimshëm, ndaj dhe kërkoj që të mos konsiderohet si shkak penalizues për mua.*

*Parashikimi i pagimit të çmimit prej 800.000 (tetëqind mijë) lekësh, në përmbajtjen e Kontratës së Sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.5.2004, duhet të ketë qenë një formulim standard i përdorur nga noteri, formulime të cilat përdoren shpesh në punën e tyre të*

përditshme. Nga unë nuk mohohet fakti se qëllimi i vërtetë i palëve në kontratën e sipërmarrjes ka qenë kalimi i pronësisë së pasurisë truall në këmbim të shumës 800.000 (tetëqind mijë) lekë, ndaj dhe lejova nisjen e ndërtimit, por për shkak të marrëdhënies me vëllanë, veprimi juridik dhe faktik i shitjes u realizua në shkurt të vitit 2008. Kontrata e shitjes erdhi si rezultat i nevojës për të shkëputur çdo raport dhe marrëdhënie juridike me këtë pasuri, si dhe për shkak të kërimit edhe nga vëllai për të bërë bashkimin midis truallit dhe objektit.

Nëse unë do të kisha përfitur shumën e shitjes së truallit në vitin 2004 do të kisha realizuar kontratën e shitjes në këtë vit, do të kisha deklaruar të ardhurat në deklaratën për vitin 2005, dhe për rrjedhojë nuk do të kisha qenë palë ndërgjyqëse në procese gjyqësore, pasi do isha zhveshur nga pasuria. Siç vërehet, vendimet gjyqësore kanë pasur si palë ndërgjyqëse Gentian Hamiti për shkak se unë vija të isha i regjistruar si pronar i truallit. Edhe vendimi gjyqësor i Gjykatës së Lartë në rastin e procesit gjyqësor me paditëse shtetasen O. Dh. ka pushuar çështjen për shkak të krijimit të rrethanave të reja sikurse ju keni cituar në rezultate të hetimit administrativ, pasi unë nuk isha më pronar truall. Kjo vendimmarrje ka ardhur si rezultat i fitimit të procesit gjyqësor nga shtetasi J. Zh., ku u vendos pavlefshmëri e kontratës së shitjes së truallit mes meje dhe Zyrës së Përmbarrimit, pra është konsideruar vendimi gjyqësor me shtetasin Zh..

Faktin e mosfshirjes së emrit tim në regjistrin hipotekor pas vendimit gjyqësor me z. Zh. e provon edhe deklarata e datës 3.5.2024, bërë prej këtij të fundit pranë nëpunësit të QSHQ-së, sipas së cilës deklarohet: Unë, deklaruesi J. Zh. (J. Zh.), shtetas grek, deklaroj se: Kam qenë në konflikt gjyqësor me z. Gentian Hamiti lidhur me pronësinë e një pasurie të paluajtshme me sip. 300 m², që ndodhet në qytetin e Delvinës, lagjja “***”, Delvinë. Fillimi i procedurës gjyqësore ka pasur pikënisjen e saj për shkak të fillimit të ndërtimit në këtë truall. Për këtë procedurë gjyqësore, Gjykata e Apelit Gjirokastër ka vendosur në favorin tim. Në rrethanat që shtetasi F. H. më ofroi një dëmshpërblim të kënaqshëm monetar duke përfshirë edhe shpenzimet gjyqësore, humba interesin për këtë truall dhe hoqa dorë përfundimisht prej tij bashkë me ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Apelit.

Ky fakt provohet edhe nga Deklarata Noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.2.2024, e z. K. M., me profesion avokat, me nr. licence *** dhe përfaqësues ligjor i z. J. Zh., pajisur me prokurë të përgjithshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.10.1998. Sipas përmbajtjes së kësaj deklarate: Unë, z. K. M., me profesion Avokat pranë Dhomës së Avokatisë Sarandë, me nr. licence *** dhe NUIS ***, deklaroj se jam përfaqësues ligjor i shtetasit grek J. Zh., pajisur me Prokurë të Përgjithshme nr. *** rep., nr. *** kol., 29.10.1998. Kopje të kësaj prokure të përgjithshme ia bashkëlidh kësaj deklarate. Deklaroj se i përfaqësuari prej meje, z. J. Zh., ka zhvilluar një proces gjyqësor me z. Gentian Hamiti, për pasurinë e paluajtshme me sipërfaqe truall 300 m², të ndodhur në qytetin e Delvinës. Ky proces gjyqësor ka nisur menjëherë pasi është konstatuar se mbi këtë truall po ndërtohej. Padia e z. J. Zh. është pranuar nga Gjykata e Apelit Gjirokastër me vendimin nr. ***, datë 16.11.2004, me të cilin ka vendosur: “Pranimin e padisë. Anulimin e veprimeve përmbarrimore. Ankand për shitjen e truallit të datës 10.1.2002” të Zyrës së Përmbarrimit Sarandë. Anulimin e vendimit nr. ***, datë 11.12.2002, të përmbarruesit për kalim pronësie. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Kontratës së Shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.12.2002, fshirjen e saj nga ZRPP-ja Sarandë dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme. Në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të pajisur me prokurë të përgjithshme, unë, avokati K. M., deklaroj se z. J. Zh. nuk e ka vendosur ndonjëherë në ekzekutim vendimin nr. ***, datë 16.11.2004, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, pasi në dijeninë time ai është shlyer për të, rreth vitit 2005. Ndërkohë nga vërtetimi nr. *** prot., datë 29.2.2024, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, rezulton se nga verifikimi në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, si dhe në regjistrat manualë nuk rezulton që pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë të jetë paraqitur ndonjë kërkesë ose të jetë dhënë ndonjë vendim me objekt “Lëshimin e urdhrorit të ekzekutimit të vendimit nr. ***, datë 5.5.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

*Sarandë” (vendimi i cili është ndryshuar me vendimin nr. ***, datë 16.11.2004, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë). Pra, titulli ekzekutiv, vendimi nr. ***, datë 5.5.2004, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, ndryshuar me vendimin nr. ***, datë 16.11.2004, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, nuk është ekzekutuar asnjëherë për mungesë të urdhrit të ekzekutimit dhe, për rrjedhojë, Kontrata e Shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.2.2008, e cila është lidhur në bazë të tagrave të pronarit, vijonte të kishte vlefshmëri juridike. Sa kujtoj, Deklarata Noteriale nr. *** rep., datë 14.12.2009, më është kërkuar nga vëllai. Si e pyeta, vëllai më informon se deklarata në atë kohë i ishte kërkuar nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë, për shkak të aplikimit për regjistrimin e bashkimit të objektit së bashku me truallin. Deklaroj se Kontrata e Shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.2.2008 dhe Deklarata Noteriale nr. *** rep., datë 14.12.2009, nuk janë bërë ndonjëherë objekt shqyrtimi gjyqësor dhe, për këtë shkak, ato nuk mund të konsiderohen se janë nul.*

*Lidhur me pagesën e tatimit në burim nga shitja e pasurisë truall sqaroj se: “Në datën 23.11.2009 është bërë dhe pagesa e tatimit mbi kalimin e të drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme sipas parashikimeve të nenit 11 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, në shumën 58.500 (pesëdhjetë e tetë mijë e pesëqind) lekë, provuar me mandatarëkëtimin nr. ***, datë 23.11.2009. Pagesa e tatimit mbi kalimin e të drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, e kryer në datën 13.11.2009, është bërë në përputhje dhe me parashikimet e Udhëzimit nr. 9, datë 26.2.2008, “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme”.*

Pavarësisht kësaj pagese, e cila nuk ishte memorizuar nga unë, sërish e kam paguar këtë detyrim tatimor në vitin 2019.

Në lidhje me këtë shumë të deklaruar prej meje [800.000 (tetëqind mijë) lekë] deklaroj se ajo është konsumuar për shpenzime jetese dhe nuk ka shërbyer për blerje të ndonjë pasurie të luajtshme apo e paluajtshme, në kuptim të pikës 11 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

20.11 Trupi gjykues, pasi analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, faktet e rrethanat mbi të cilat është mbështetur hetimi i Komisionit, në raport me dokumentacionin e administruar, vëren se konstatimet pjesë e rezultateve të hetimit, përputhen me deklaratimet e vetë subjektit në deklaratat periodike dhe atë *Vetting*. Problematika e hasur gjatë verifikimit të kësaj situate në të cilën u gjend subjekti deri në shkurt të vitit 2008, duket si shkak i një marrëdhënieje juridike civile mbetur e ndërvarur prej asaj të krijuar në vitet 2002 – 2004 e se nuk lidhet në ndonjë situatë me ushtrimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit apo përfitime të tij nga funksioni publik. E parë në këndvështrimin e dispozitave të Kodit Civil, marrëdhënia juridiko-civile duket se ka pasur një sërë mosmarrëveshjes e se në fund ajo është zgjidhur me marrëveshje mes palëve. E parë në këndvështrim të përgjegjësisë së subjektit të rivlerësimit, duhet vlerësuar edhe marrëdhënia e posaçme që e ka lidhur atë me investitorin (vëllai i tij), për të cilën ai është gjendur në rrethana të ndërlikuara që kanë kërkuar zgjidhje juridiko-civile.

20.12 Nga vlerësimi në tërësi i të gjitha veprimeve juridike të kryera nga palët dhe të cituara më lart e të provuara me dokumentacion ligjor nga subjekti i rivlerësimit rezulton se marrëdhënia juridiko-civile ka filluar në vitin 2002 (fakt ky i pakontestuar), ajo është pasuar nga një sërë veprimesh juridike, të cilat kanë mundësuar kalimin e të drejtës së pronësisë tek investitorët (familjare të subjektit) vetëm në shkurt të vitit 2008, ku subjekti është liruar përfundimisht nga kjo marrëdhënie pronësie, megjithëse rezultoi e provuar se me veprime konkludente e dokumentacion shkresor ajo ka filluar prej vitit 2004. Gjatë verifikimeve për këtë pasuri nuk rezultuan të dhëna që të ngrinin dyshime se kjo mund të ishte një pasuri e subjektit të rivlerësimit, qoftë edhe pjesërisht apo se ai mund të kishte investuar në të, pasi vetë objekti rezultoi se kishte thujse përfunduar dhe regjistruar si ndërtime në vitin 2005 e se subjekti i rivlerësimit është bërë gjyqtar (magjistrat) në vitin 2007. Po ashtu, nuk rezultuan të dhëna se ai mund të kishte të ardhura për të kryer këtë investim.

20.13 Subjekti ka deklaruar në DPV-në e vitit 2007 (dorëzuar në mars 2008) marrëdhënien kontraktore dhe shumën e përfituar duke zbatuar detyrimin për deklarim të kësaj shume nëpërmjet deklarimit të tij sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, për shkak se marrëdhënia e deklaruar prej tij më herët në vitin 2005, rezultoi e ndjekur nga një sërë veprimesh juridike.

Trupi gjykues çmon se mosdeklarimi prej tij në DPV-në 2007 – 2008 do të sillnin pasaktësi në deklarimin periodik vjetor e do të bënin gjithashtu më të vështirë verifikimin mbi vërtetësinë e fakteve duke e lënë këtë marrëdhënie të papërfunduar (në këndvështrim të deklarimeve ndër vite).

20.14 Duke konsideruar këto rrethana, vlerësojmë se pasojat ligjore të krijuara prej kësaj marrëdhënieje nuk lidhen me asnjë nga rrethanat e kërkuara nga neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi edhe në kuptim të deklarimeve subjekti i ka deklaruar ato dhe shpjegimet e tij vijnë në harmoni me deklaratimet dhe situatën faktike të referuar e të dokumentuar prej tij.

20.15 Në përmbledhje të këtyre konkluzioneve, trupi gjykues vlerëson të nënvizojë qëndrimin se analiza e veprimeve ligjore të përshkruara më lart, vlen të kryhet në këtë proces jo për të konkluduar dhe marrë qëndrime apo vendime të natyrës së gjykimeve civile, kompetencë e cila del jashtë juridiksionit të rivlerësimit kalimtar, për shkak të juridiksionit tërësisht disiplinor që ky proces ka në zbatim të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, por për të analizuar nëse në thelb të këtyre veprimeve me natyrë civile gjenden elemente që tregojnë për përpjekjeje për të kamufluar veprime të subjektit të rivlerësimit që vijnë ndesh me urdhërimet ligjore në fuqi e të cilat përfaqësojnë përpjekje për të justifikuar pasuri të fituara me burime të paligjshme apo për të justifikuar mungesën e burimeve të ligjshme, si edhe për të mbuluar deformimet në deklaratimet e bëra në deklaratën *Vetting*, qofshin ato fshehje të pasurive apo deklarime të rreme.

20.16 Një element tjetër që u vlerësua në këtë çështje është edhe sjellja e subjektit të rivlerësimit në raport me këtë marrëdhënie juridiko-civile, vlerësuar në raport me cenimin e besimit të publikut të drejtësia. Në këtë këndvështrim, trupi gjykues çmon se elementet e etikës gjyqësore, sipas parashikimeve të nenit 43, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, që të referon te parashikimi i nenit 75 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, por edhe ato të etikës jashtëgjyqësore, vlerësojmë se duhet të analizohen në raport me elementet e tjera të këtij kriteri, për t’u dhënë atyre peshën e duhur dhe për të vlerësuar në zbatim të parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit efektin që ato do të kenë në konsiderimin e shkeljeve të kësaj natyre, kur ato ekzistojnë. Trajtimi i tyre më vete dhe si element përbërës i kriterit të kontrollit të pasurisë, nuk lejon një vlerësim objektiv të vetë rrethanave konkrete të pretenduara se përbëjnë shkeljen e etikës, ndaj do të trajtohet e vlerësohet në vlerësimin tërësor të çështjes.

21. Gjendje cash në shtëpi në vlerën 400.000 (katërqind mijë) lekë, me burim krijimi kursimet nga të ardhurat nga paga, për periudhën 2014 – 2015, në shumën 200.000 (dyqind mijë) lekë për vitin 2014 dhe 200.000 (dyqind mijë) lekë në vitin 2015.

a) Nga verifikimi i deklaratave periodike të subjektit të rivlerësimit rezulton se në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës viti 2007 (dorëzuar në mars 2008), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Gjendje cash vlera 1.300.000 (një milion e treqind mijë) lekë*”.

b) Në DPV-në e vitit 2012 subjekti i rivlerësimit deklaroi se për pasurinë automjet “Mercedes-Benz” në shumën 3.500 (tre mijë e pesëqind) euro, si burim kanë shërbyer të ardhura të disponueshme para fillimit të detyrës.

c) Në pyetësorin drejtuar bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit¹⁴, ajo është pyetur lidhur me kursimet *cash* të bashkëshortit, e cila në përgjigje ka deklaruar: “*Në lidhje me sa kërkohet deklaroj se, pasi kam pyetur bashkëshortin, më ka sqaruar se kjo shumë në vitin 2012 ka qenë*

¹⁴ Pyetësori nr. 3, datë 15.11.2022, A. Hamiti.

0 (zero). Shuma është konsumuar gradualisht gjatë viteve 2007 – 2012, derisa në vitin 2012, është bërë 0 (zero)”.

ç) Në DPV-në e vitit 2014, subjekti i rivlerësimit deklaroi kursime nga të ardhurat nga paga në shumën 200.000 (dyqind mijë) lekë, të cilën e disponon *cash* në shtëpi.

d) Në DPV-në e vitit 2015, subjekti i rivlerësimit deklaroi kursime nga paga, në shumën 200.000 (dyqind mijë) lekë, e disponuar *cash* në shtëpi, ndërsa pjesa tjetër e pagës, duke zbritur shumën 3.544,24 (tre mijë e pesëqind e dyzet e katër e njëzet e katër të qindtat) lekë, e cila ka qenë gjendje e llogarisë së pagës në datën 31.12.2015, pranë BKT-së, është konsumuar për nevoja familjare.

21.1 Komisioni vlerësoi në tërësi deklaratimet e subjektit dhe konsideroi në analizën financiare gjendjen *cash* sipas deklaratave periodike dhe shpjegimeve të dhëna prej tij dhe personi i lidhur. Nga analiza e përgjithshme financiare rezultoi se për periudhën 2014 – 2015, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë pasur mundësi financiare të krijojnë kursimet e deklaruara si likuiditete *cash* në Deklaratën *Vetting* dhe në DPV-të e viteve 2014 dhe 2015, si dhe të mbulojnë shpenzimet e tjera familjare¹⁵. Lidhur me deklarin e gjendjes *cash* në DPV-të gjatë periudhës 2007 – 2012, subjekti i rivlerësimit rezultoi me mundësi financiare, porse duket të ketë pasaktësi në deklarin e gjendjes *cash* gjatë këtyre viteve.

21.2 Lidhur me këtë konstatim, subjektit të rivlerësimit i është kërkuar të deklarojë qëndrimin e tij, i cili, në vijim, shpjegon se: “Gjatë viteve 2007 – 2012 gjendja *cash* është konsumuar gradualisht. Nuk jam në gjendje të përcaktoj vlerën e saktë se sa është pakësuar për secilin vit, për shkak të kohës së largët, por di të them se nuk kam kryer shpenzime në atë shumë, për të cilën kam pasur detyrimin për deklarin sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”. Gjatë këtyre viteve nuk kam blerë/investuar në asnjë pasuri të paluajtshme ose të luajtshme, në kuptim të pikës 11 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, përveç vitit 2012, kur kam blerë automjetin në vlerën 3.500 (tre mijë e pesëqind) euro”.

21.3 Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se deklaratimet periodike të periudhës 2007 – 2012 të subjektit të rivlerësimit kanë pasaktësi në lidhje me deklarin e gjendjes *cash*, por analizuar dhe parë në harmoni me dispozitat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, i cili kërkon si një parakusht për përgjegjësinë disiplinore për efekt të këtij procesi, përpjekjet e subjektit për defektimin e deklaratimeve të tij në deklaratën *Vetting*, parakusht që përjashton pasaktësitë në deklarime, si një premisë për shkarkim, përveç rastit kur ato janë kryer me qëllim fshehjen e pasurisë e deklarin e pasaktë të të dhënave, përfshirë këtu edhe ato lidhur me burimet e krijimit të pasurisë, të cilat natyrshëm nuk mund të kualifikohen si pasaktësi, por si deklarime të rreme dhe fshehje të pasurisë, interpretuar në harmoni me parashikimin kushtetues, pasaktësitë e konstatuara në deklaratimet periodike nuk mund të shërbejnë si shkelje të tilla, të cilat të formojnë bazën e duhur ligjore për aplikimin e masës disiplinore.

22. Gjendje llogaria e pagës, në datën 19.1.2017, në shumën 3.791 (tre mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e një) lekë

22.1 Banka Kombëtare Tregtare¹⁶ informon se subjekti i rivlerësimit Gjentian Hamiti ka llogari me gjendje 3.791,42 (tre mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e një e dyzet e dy të qindtat) lekë, në datën 25.1.2017 (datën e dorëzimit të deklaratës *Vetting*).

22.2 Nga verifikimi rezultoi se kjo ishte llogaria ku subjektit i kalonin të ardhurat nga paga e për të cilat nuk rezultuan probleme financiare.

¹⁵ Për më shumë informacion referojuni analizës financiare në *excel*.

¹⁶ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 10.3.2021, dosja e hetimit.

DEKLARIMI I PASURISË SË BASHKËSHORTES, ARMIDA HAMITI (MOÇKA)

23. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar bashkëjetesën me znj. Armida Moçka në vitin 2012 dhe martesë me tyre është lidhur në datën 25.10.2013. Nga verifikimi i deklaratës *Vetting* për znj. Moçka ka rezultuar sa më poshtë.

23.1 Akti i Marrjes së Tokës në Përdorim

a) Nr. regj. Akti ***, datë 11.10.1994, për pasurinë me sip. 5.000 m² (në bashkëpronësi me familjen bujqësore të përbërë nga 5 anëtarë), i paregjistruar në regjistrat publikë, ndodhur në fshatin ***, Vlorë. Pjesa takuese: 20%.

b) Nr. regj. Akti ***, datë 6.3.1993 (në bashkëpronësi të familjes bujqësore të përbërë nga 5 anëtarë), fshati ***, Vlorë, i paregjistruar në regjistrat publikë, nga të cilët sipërfaqja prej 444 m² është shpronësuar¹⁷ me VKM-në Nr. 482, datë 23.6.2010. Pjesa takuese: 20%.

23.2 Këto pasuri janë vlerësuar nga trupi gjykues që ka kryer procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin A. Moçka (Hamiti), trajtuar me vendimin nr. 605/2022 të Komisionit, **si dhe rezultojnë krijuar përpara marrëdhënies si person i lidhur me subjektin e rivlerësimit.**

24. **Apartament banimi me sip. 106 m², blerë 50.000 (pesëdhjetë mijë) euro, në Vlorë**, me Kontratë Porosie datë 4.5.2011 dhe Kontratën Përfundimtare të Shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.9.2012. Apartamenti është në bashkëpronësi të familjes bujqësore të origjinës, me të ardhura të siguruara nga aktiviteti i familjes bujqësore prej vitit 1994 deri në vitin 2011, me pjesë takuese: 20%.

24.1 Nga verifikimet e kryera nga Komisioni ka rezultuar se pasuria apartament banimi deklarohet nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit për herë të parë në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, të dorëzuar në datën 14.12.2011, me përshkrimin “Apartament banimi, Kontratë Porosie datë 4.5.2011, 116 m², lagjja “****”, Vlorë. Vlera 50.000 (pesëdhjetë mijë) euro”. Edhe në DPV-në e po këtij viti 2011, subjekti e ka deklaruar këtë pasuri me të njëjtat të dhëna.

24.2 Në lidhje me origjinën e kësaj pasurie, nga verifikimet e dokumentacionit të administruar rezultoi se ajo është përfituar sipas Kontratës së Porosisë datë 4.5.2011¹⁸ dhe Kontratës përfundimtare të Shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.9.2012¹⁹. Kjo pasuri konfirmohet në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, sipas “Certifikatës për vërtetim pronësie” datë 17.9.2012.

24.3 Lidhur me likuidimin e kësaj pasurie, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar rezulton se shuma 50.000 (pesëdhjetë mijë) euro për blerjen e apartamentit është paguar e ndarë në 5 këste, të cilat janë paguar nëpërmjet sistemit bankar, duke i kaluar shumat nga llogaria e shtetasës A. Moçka në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k., përkatësisht:

a) paguar nëpërmjet NBG-së (sot ABI Bank) me transfertë, 4 këste, secila në shumën 10.000 (dhjetë mijë) euro, me përshkrimin “Pagesë për blerje apartamenti” në datat: 24.5.2011; 30.5.2011; 19.8.2011 dhe 26.8.2011;

b) paguar përmes depozitimit *cash* shuma 10.000 (dhjetë mijë) euro në llogarinë e shoqërisë me përshkrimin “Pagesë për blerje apartamenti”, në datën 17.8.2011.

24.4 Në lidhje me regjimin juridik pasuror martesor të kësaj pasurie, në analizim të dokumentacionit të administruar Komisioni vëren se bazuar në ligjin nr. 9062, datë 8.5.2003, “Kodi i Familjes”, i ndryshuar, kreu II, nenet 73 e vijues, pasuria “apartament” nuk rezulton të

¹⁷ Të ardhura nga shpronësimi i pronës me VKM-në Nr. 482, datë 23.6.2010, në vlerën 710.400 lekë.

¹⁸ Kontratë Porosie datë 4.5.2011, me palë shoqëria “****” sh.p.k. dhe Armida Moçka për porositje apartamenti me sip. 116 m², vlera 50.000 (pesëdhjetë mijë) euro.

¹⁹ Kontratë Shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.9.2012, me palë shitëse shoqëria “****” sh.p.k. dhe palë blerëse A. M., për blerje apartamenti me sip. 116 m², vlera 6.800.000 lekë, e konvertuar 50.000 (pesëdhjetë mijë) euro, vlerë e likuiduar totalisht; Certifikatë për Vërtetim Pronësie nr. ***, datë 13.4.2012, për apartamentin me sip. 106 m², nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, Vlorë, në pronësi të shoqërisë “****” sh.p.k. + kartelë pasurie + praktikë e shoqërisë “****” sh.p.k. Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

jetë një pasuri e fituar gjatë martesës, por e krijuar nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit dhe familja e saj, përpara marrëdhënies si “person i lidhur” me subjektin e rivlerësimit.

24.5 Kjo pasuri është vlerësuar nga trupi gjykues që ka kryer procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin A. Moçka (Hamiti), trajtuar me vendimin nr. 605/2022 të Komisionit, **si dhe rezulton e krijuar përpara marrëdhënies si person i lidhur me subjektin e rivlerësimit.**

25. Të ardhura nga aktiviteti privat familjar bujqësor “Vreshtari, ullishtë, bujqësi, shpendari dhe blegtori” (në bashkëpronësi të familjes bujqësore të përbërë nga 5 anëtarë) të krijuara në periudhën 1994 – 2011, në vlerën 53.000 (pesëdhjetë e tre mijë) euro, duke sqaruar se kjo vlerë është depozituar në bankat e nivelit të dytë shuma 50.000 (pesëdhjetë mijë) euro, ndërsa në datën 3.12.2015 kontratat e depozitave janë mbyllur dhe transferuar në emër të prindit. Pjesa takuese: 20%.

25.1 Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit i deklaroi për herë të parë këto të ardhura në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës, të dorëzuar në datën 14.12.2011, me përshkrimin “Të ardhura nga aktiviteti privat i familjes bujqësore, ullishtë, vreshtari, bujqësi në vlerën 53.000 (pesëdhjetë e tre mijë) euro”.

25.2 Nga dokumentacioni i administruar nga bankat e nivelit të dytë rezultoi se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka depozituar shumën 50.000 (pesëdhjetë mijë) euro, përkatësisht në Abi Bank (ish-NBG), Tirana Bank dhe Intesa Sanpaolo Bank.

25.3 Nga analizimi i statement në secilën bankë rezultoi se ka kryer transaksionet e mëposhtme:

a) Znj. A. Moçka në datën 5.8.2011 ka depozituar në Abi Bank shumën 10.000 (dhjetë mijë) euro, e cila ka kaluar në depozitë në datën 8.11.2011, maturuar çdo vit deri në vitin 2015. Në datën 30.11.2011 ka depozituar në po këtë bankë shumën 10.000 (dhjetë mijë) euro, e cila ka kaluar në depozitë në datën 1.12.2011, maturuar për çdo vit deri në vitin 2015. Në vitin 2015, të dyja depozitat së bashku në Abi Bank, pas maturimit dhe interesave të përfituar për çdo vit, kanë arritur vlerën 21.726,87 (njëzet e njëmijë e shtatëqind e njëzet e gjashtë e tetëdhjetë e shtatë të qindtat) euro. Kjo shumë është transferuar në datën 6.7.2015 në llogarinë e znj. Moçka në Intesa Sanpaolo Bank.

b) Znj. Armida Moçka ka depozituar në datën 3.8.2012, në Tirana Bank, shumën 20.000 (njëzet mijë) euro me përshkrimin “Të ardhura nga aktiviteti privat bujqësor”, e cila është kaluar në depozitë, si dhe është maturuar për çdo vit deri në vitin 2015. Në datën 7.7.2015, depozita ka arritur vlerën 21.135 (njëzet e njëmijë e njëqind e tridhjetë e pesë) euro dhe kjo shumë është transferuar në llogarinë e znj. Armida Moçka (Hamiti) në Intesa Sanpaolo Bank.

c) Znj. A. Moçka ka depozituar në datën 7.11.2011 në Intesa Sanpaolo Bank shumën 10.000 (dhjetë mijë) euro, e cila ka kaluar në depozitë dhe është maturuar për çdo vit deri në vitin 2015. Kësaj shume i është shtuar në vitin 2015, vlerën 21.726,87 (njëzet e njëmijë e shtatëqind e njëzet e gjashtë e tetëdhjetë e shtatë të qindtat) euro transferuar nga Abi Bank dhe vlerën 21.135 (njëzet e njëmijë e njëqind e tridhjetë e pesë) euro, transferuar nga Tirana Bank. Shuma e transferuar si rezultat i akumulimit të të gjitha depozitave dhe interesave bankare ka qenë në vlerën 53.356,84 (pesëdhjetë e tre mijë e treqind e pesëdhjetë e gjashtë e tetëdhjetë e katër të qindtat) euro.

26. Të ardhurat në depozitë në Tirana Bank, në vlerën 53.356 (pesëdhjetë e tre mijë e treqind e pesëdhjetë e gjashtë) euro, të cilat në datën 3.12.2015, janë transferuar nga znj. A. Moçka (Hamiti) në llogarinë e nënës së saj, znj. L. M. (datë 12.11.1962).

26.1 Komisioni vëren se këto të ardhura janë depozituar në bankë nga znj. Armida Moçka në periudhën mes viteve 2011 – 2012, duke deklaruar se kanë pasur si burim të ardhurat nga familja bujqësore e familjes së origjinës së znj. A. Moçka, e cila rezultoi sipas dokumenteve të jetë pjesë e familjeve bujqësore të zonës me aktivitet bujqësor e blegtoral. Lidhur me shumën

e depozituar dhe mundësitë financiare për krijimin e kësaj gjendjeje likuiditetesh është hetuar nga trupi gjykues që ka vlerësuar znj. A. Moçka për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar. Kjo shumë në vetvete është krijuar para lidhjes së martesës me subjektin e rivlerësimit Gentian Hamiti dhe është transferuar në llogarinë e prindërve të znj. Moçka në vitin 2015 (duke vlerësuar se është kthyer në vendin e origjinës). Gjithashtu, kjo shumë nuk është përdorur për krijimin e ndonjë pasurie apo interesi tjetër që lidhet me subjektin e rivlerësimit objekt vlerësimi.

26.2 Në lidhje me regjimin juridik pasuror martesor të kësaj pasurie, në analizim të dokumentacionit të administruar, Komisioni vëren se bazuar në ligjin nr. 9062, datë 8.5.2003, “Kodi i Familjes”, i ndryshuar, kreu II, nenet 73 e vijues, pasuria nuk rezulton të jetë e fituar gjatë martesës.

26.3 Trupi gjykues vlerëson se përputhet deklarimi i personit të lidhur/bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit me deklarimin e bërë prej saj në deklaratën Vetting. Kjo çështje vlerësohet se nuk afekton subjektin e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar, pasi nuk ka ndikuar në krijimin e ndonjë pasurie e se lidhur me pozicionin e vetë znj. A. Moçka ajo është vlerësuar me vendimin nr. 605/2022 të Komisionit.

27. Garazh me sip. 23,04 m², regjistruar në ZVRPP-në Vlorë, me nr. pasurie ***, blerë me Kontratën e Shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.9.2012. Burim krijimi: të ardhura nga paga dhe aktiviteti privat bujqësor i familjes bujqësore (pasuria garazh është në bashkëpronësi të familjes bujqësore të origjinës e përbërë nga 5 anëtarë). Vlera: 500.000 (pesëqind mijë) lekë. Pjesa takuese: 20%.

27.1 Kjo pasuri deklarohet nga znj. A. Moçka në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë për vitin 2012, me përshkrimin “Në datën 10.9.2012, Kontratë Shitjeje për blerje garazhi nr. *** rep., nr. *** kol., me sip. 23.04 m², me të ardhura nga puna dhe nga aktivitet privat. Vlera: 500.000 (pesëqind mijë) lekë”.

27.2 Nga verifikimi rezulton se sipas Kontratës së Shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.9.2012, rezulton se shitësi E. H. i shet znj. Armida Moçka (blerësi) pasurinë garazh në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) lekë, shumë e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale.

27.3 ZVRPP Vlorë²⁰ konfirmon se në emër të znj. Armida Moçka figuron e regjistruar pasuria garazh me sip. 23.04 m², me nr. pasurie ***.

27.4 Znj. Moçka, e pyetur²¹ gjatë hetimit administrativ të kryer për të për këtë pasuri, ka sqaruar: “Në lidhje me vlerën 500.000 (pesëqind mijë) lekë të paguar për blerjen e garazhit deklaroj se nga ky çmim janë paguar 3.000 (tre mijë) euro nga të ardhurat e aktivitetit privat bujqësor dhe blegtoral. Kjo shumë e konvertuar nga euro me lekë sipas kursit zyrtar të këmbimit të datës 10.9.2012, 1 (një) euro e barabartë me 138,09 (njëqind e tridhjetë e tetë presje zero nëntë) lekë, ishte 414.270 (katërqind e katërmbëdhjetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë) lekë. Pjesa tjetër e çmimit, diferenca në shumën 85.730 (tetëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e tridhjetë) lekë është paguar me të ardhurat nga paga e funksionit si prokurore”.

27.5 Lidhur me deklarimin për burimin e krijimit për pasurinë garazh²², trupi gjykues i është referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin përfunduar me vendimin nr. 605/2022 të Komisionit²³, duke arritur në konkluzionin se ajo ka burime financiare të mjaftueshme për krijimin e pasurisë.

27.6 Në përfundim, trupi gjykues çmon se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar duke mos rezultuar problematika.

²⁰ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 4.9.2017, Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së, s. r. A. Moçka (Hamiti).

²¹ Pyetësi nr. 2 sipas shkresës nr. *** prot., datë 15.11.2022.

²² Shihni pikën 25.22 të vendimit nr. 605, datë 21.12.2022, të Komisionit, s.r. A. Hamiti.

²³ Shihni vendimin nr. 605, datë 21.12.2023 për s. r. Armida Hamiti (Moçka), pika 25.44, f. 30.

28. Automjeti tip “Golf Volkswagen”, blerë me Kontratën e Shitjes datë 10.12.2015, me vlerë 1.450 (njëmijë e katërqind e pesëdhjetë) euro. Blerë me të ardhurat e siguruara nga shitja e automjetit tip “Peugeot”, me targë ***, në vlerën 1.000 euro dhe pjesa tjetër me të ardhurat nga paga. Pjesa takuese: 100%.

28.1 Personi i lidhur e deklaroi për herë të parë blerjen e këtij mjeti në DPV-në e vitit 2015, me përshkrimin “Blerje automjeti i tipit “Volkswagen” në shtetin gjerman, nëpërmjet Kontratës së Blerjes së datës 10.12.2015 (kjo autoveturë është blerë nga të ardhurat e realizuara nga shitja e automjetit tip “Peugeot”, me targë ***, dhe pjesa tjetër nga të ardhurat nga paga). Vlera: 1.450 (njëmijë e katërqind e pesëdhjetë) euro”.

28.2 Sipas dokumentacionit të përcjellë nga DPSHTRR-ja²⁴, rezultoi se shtetasja Armida Ll. Hamiti, aktualisht ka të regjistruar mjetin me targë ***, ku konfirmohet blerja e tij në datën 10.12.2015, në vlerën 1.450 (njëmijë e katërqind e pesëdhjetë) euro. Ky mjet është zhdoganuar në datën 31.12.2015, në vlerën 84.680 (tetëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë.

28.3 Nga analiza financiare rezultoi se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka pasur mundësi financiare për blerjen e automjetit në vitin 2015.

28.4 Trupi gjykues vlerëson se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar, duke mos rezultuar problematika.

GJETJE TË TJERA

29. Abi Bank informon²⁵ se subjekti i rivlerësimit në datën 26.10.2009 ka çelur llogari bankare me nr. *** dhe mbyllur atë në datën 29.1.2013.

29.1 Nga hetimi rezultoi se në datën 26.10.2009 është kredituar në llogarinë e subjektit të rivlerësimit shuma 2.500 (dy mijë e pesëqind) euro me referencë “Depozitim nga A. B.”, shumë e cila është tërhequr nga llogaria po në këtë datë nga subjekti i rivlerësimit.

29.2 Subjektit i është kërkuar të japë shpjegime lidhur me këtë konstatim, si dhe të sqarojë marrëdhënien me shtetasin A. B. në lidhje me këtë transaksion bankar dhe, në vijim, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *“Për sa kërkohet sqaroj se me z. A. B. kam përfunduar Shkollën e Magjistraturës. Me këtë shtetas kam pasur një marrëdhënie korrekte, siç ka qenë marrëdhënia ime dhe me të gjithë studentët e tjerë. Në vitin 2009, sipas kërkesës së tij, i kam huazuar shumën 2.500 (dy mijë e pesëqind) euro, shumë e cila ka derivuar nga çmimi i Kontratës së Shitjes së Truallit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.2.2008, me sip. 300 m². Kjo shumë më është kthyer prej tij rreth muajit tetor 2009, nëpërmjet sistemit bankar. Kjo mënyrë pagese është bërë për shkak të pamundësisë kohore për t’u takuar personalisht, si dhe distancës gjeografike të qyteteve në të cilat ne ushtronim funksionet respektive si magjistratë. Veprimet më sipër, dhënia e huas dhe kthimi i saj janë veprime që kanë ndodhur brenda të njëjtit vit kalendarik”.*

29.3 Gjatë seancës dëgjimore u pyet subjekti lidhur me marrëdhënien e tij me shtetasin A. B. (gjithashtu subjekt rivlerësimi) e, konkretisht, lidhur me deklaratimet e bëra prej tij për këtë marrëdhënie²⁶ (veprimet bankare të referuara më lart), për të cilat ai tha se nuk ishte njohur më parë me to e se kishte të njëjtin shpjegim për këtë çështje.

29.4 Nga trupi gjykues kjo çështje nuk u konsiderua me probleme në deklaratim që mund të shërbejnë si shkelje të tilla që të formojnë bazën e duhur ligjore për aplikimin e ndonjë mase disiplinore e për më tepër që ky element nuk prodhon ndonjë pasojë apo efekt të rëndësishëm mbi analizën e Komisionit, për sa i përket zotërimit të pasurisë likuiditet, për të cilën ka

²⁴ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 14.8.2020, dosja e hetimit, s.r. Armida Hamiti (Moçka).

²⁵ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 2.3.2021, dosja e hetimit.

²⁶ Shihni Vendimin nr. 624, datë 20.2.2023, të Komisionit.

rezultuar se subjekti ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme/konsiderueshme për të mbuluar të gjitha shpenzimet.

30. Gjatë hetimit administrativ janë shqyrtuar e krahasuar të gjitha dokumentet e vëna në dispozicion lidhur me objektin truall + ndërtesë, në qytetin e Delvinës, nga ku është konstatuar ekzistenca e dy lejeve të ndërtimit, të lëshuara për të njëjtën pronë truall, e cila ishte e regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit, konkretisht:

Ndryshimet	Dosja e Bashkisë Delvinë	Dosja e gjykatës
Vendimi i lejes së ndërtimit KRRT nr. dhe datë	*** datë 30.4.2004	*** datë 30.4.2004
Data e nënshkrimit të lejes së ndërtimit	16.4.2004	3.8.2004
Personat nënshkrues	D. A./I. J.	D. A./I. J.
Shoqëria e ndërtimit	*** sh.p.k.	*** sh.p.k.
Investitori	A. dhe F.H.	Gentian Hamiti

30.1 Lidhur me këtë konstatim u kërkua informacion pranë Bashkisë Delvinë, e cila në përgjigjen²⁷ e saj sqaron se Leja e Ndërtimit me vendimin nr. ***, datë 30.4.2004, të KRRT-së, financuar/me investitor Gentian Hamiti, me shoqëri ndërtimi “****” sh.p.k., është lëshuar gabimisht.

30.2 Referuar Kontratës së Sipërmarrjes të nënshkruar në datën 10.5.2004 midis shtetasve Gentian Hamiti dhe A. e F. H., këta të fundit figurojnë si investitorë në lejen e ndërtimit të korigjuar me vendimin nr. ***, datë 30.4.2004, të KRRT-së.

30.3 Leja e saktë e ndërtimit me vendimin nr. ***, datë 30.4.2004, të KRRT-së, në bazë të të cilit u ndërtua objekti 5-katësh, i është lëshuar shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k. dhe investitorëve F. dhe A. H..

30.4 Sa më sipër, Komisioni ka arritur në përfundimin se ndërtesa 5-katëshe mund të jetë financuar [në vlerën 11.934.706 (njëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e tridhjetë e katër mijë e shtatëqind e gjashtë) lekë] nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe se ajo mund të jetë një pasuri e fshehur e tij.

30.5 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i ka kaluar barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit dhe në vijim të këtij dyshimi të arsyeshëm nga Komisioni subjektit i është kërkuar të sqarojë në mënyrë kronologjike dhe shteruese historikun e krijimit dhe tjetërsimit të pasurisë, veprimet juridike të ndodhura dhe dokumentacionin justifikues lidhur me këtë pasuri, si dhe çdo argument tjetër që ai vlerëson të arsyeshëm.

30.6 Në prapësimet e tij subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: “Nuk ekziston fshehje pasurie nga ana ime për shkak se:

*Përveçse përherë dhe në çdo kohë kam zbatuar me korrektësi Kushtetutën dhe ligjet e vendit tim, në kohën e ndërtimit të objektit lokal + banesë (1+5), në lagjen “****”, Bashkia Delvinë, nuk kam qenë subjekt i posaçëm sipas parashikimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”.*

*Në datën 1.6.2005 jam emëruar në detyrën e oficerit të policisë gjyqësore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë, ndërsa Leja e Ndërtimit nr. *** mban datën 30.4.2004, Kontrata e Sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., mban datën 10.5.2004, akti i kolaudimit në emër të investitorëve F. H. dhe A. H. mban datën 17.8.2005 dhe Leja e Shfrytëzimit të objektit mban datën 25.8.2005, dy muaj më vonë se data e emërimit si OPGJ. Pra, objekti lokal + banesë (1+5) kishte përfunduar kur unë isha emëruar oficer i policisë gjyqësore.*

²⁷ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 7.2.2024, të Bashkisë Delvinë.

Nuk kam qenë kurrë në emigracion, nuk kam qenë i regjistruar në organet tatimore për ushtrim aktiviteti tregtar, si dhe kam zbatuar përherë me devotshmëri dhe përkushtim ligjet e vendit tim. Në këto kushte dhe si një qytetar i ndershëm i këtij vendi e kam pasur të pamundur financiarisht për të përballuar dhe investuar shumën 11.934.706 (njëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e tridhjetë e katër mijë e shtatëqind e gjashtë) lekë, që përfaqëson koston e ndërtimit objekt lokal + banesë (1+5).

*Leja e Ndërtimit nr. ***, datë 30.4.2004, ku del financiar/me investitor Gentian Hamiti, me shoqëri ndërtimi “****” sh.p.k. është lëshuar me gabime nga Bashkia Delvinë, kjo provohet nga përmbajtja e shkresës nr. *** prot., datë 2.2.2024, të Bashkisë Delvinë, (administruar prej jush) në të cilën pasqyrohet: Gabimisht Leje e Ndërtimit nr. ***, datë 30.4.2004, ishte dhënë për shoqërinë ndërtuese “****” sh.p.k., duke paraqitur si investitor shtetasin Gentian Hamiti. Për këtë gabim mendoj se nuk mund të ngarkohem me përgjegjësi.*

*Leja e ndërtimit miratuar me vendimin nr. ***, datë 30.4.2004, të KRRT-së, financiar/me investitor Gentian Hamiti, me shoqëri ndërtimi “****” sh.p.k., mban datën e lëshimit 3.8.2004, pra rreth tre muaj pas nisjes së punimeve të ndërtimit, punime që sipas shkresës nr. *** prot., datë 4.3.2024, të Bashkisë Delvinë (përgjigjja nëntë), kanë filluar në muajin maj të vitit 2005.*

*Leja e Ndërtimit nr. ***, datë 30.4.2004, ku del financiar/me investitor Gentian Hamiti, me shoqëri ndërtimi “****” sh.p.k., është dhënë me gabime nga Bashkia Delvinë dhe është përdorur vetëm në proces gjyqësor, në një situatë të paqëllimshme.*

*Për zbatimin e Lejes së Ndërtimit nr. ***, datë 30.4.2004, ku del financiar/me investitor Gentian Hamiti, me shoqëri ndërtimi “****” sh.p.k. nuk ka kontraktim nga ana ime të një mbikëqyrësi punimesh sipas nenit 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, pjesë e dokumentacionit teknik të ndërtimit dhe regjistrimit.*

*Për zbatimin e Lejes së Ndërtimit nr. ***, datë 30.4.2004, ku del financiar/me investitor Gentian Hamiti, me shoqëri ndërtimi “****” sh.p.k. nuk ka kontraktim nga ana ime të një kolaudatori sipas nenit 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” dhe, për rrjedhojë, nuk ekziston një akt kolaudimi, si dhe leje shfrytëzimi në emrin tim, dokumentacione teknike të domosdoshme këto për të bërë të mundur regjistrimin e një ndërtimi, me qëllim për ta bërë pjesë të qarkullimit juridiko-civil.*

*Ndërtesa 5-katëshe është financiar nga investitorët F. H. dhe A. H., provuar nga shkresa nr. *** prot., datë 4.3.2024, e Bashkisë Delvinë (përgjigjja e pyetjes 8), sipas së cilës: Bashkia Delvinë konfirmon se investitor i objektit lokal + banesë (1+5), mbi sip. 300 m², i llojit truall, lagjja “****”, në Bashkinë Delvinë janë z. F. H. dhe z. A. H.’. Investitorët e këtij ndërtimi F.H. dhe A. H. kanë kontraktuar kolaudatorin, i cili i ka njoftuar aktin e kolaudimit datë 17.8.2005, nënshkruar prej tij dhe investitorëve. Në vijim ka dalë dhe leja e shfrytëzimit të objektit datë 25.8.2005, në emër të investitorëve F. H. dhe A. H..*

Ndërtesa 5-katëshe, financiar nga investitorët F. H. dhe A. H., është regjistruar në emër të tyre, të gjitha tjetërsimet apo qiratë tek të tretët janë bërë prej tyre, ku në asnjë rast nuk është konfirmuar ndonjë e ardhur e përfutur prej meje”.

30.7 Trupi gjykues ka analizuar dhe vlerësuar këtë pasuri edhe më lart në këtë vendim, duke analizuar veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit në raport me deklarinimin prej tij si të ardhur të shumës 800.000 (tetëqind mijë) lekë në DPV-në e vitit 2007, dorëzuar në shkurt të vitit 2008.

30.8 Në analizën e bërë edhe më sipër në këtë vendim (provat dhe faktet rezultojnë të njëjtat), marrë në konsideratë edhe faktet e provat e disponuara gjatë prapësimeve nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues arrin në përfundimin se objekti godinë 5-katësh është pasuri e vëllait të subjektit dhe kushëririt të tij e se nuk ka asnjë dyshim se ajo është pasuri e investuar nga subjekti i rivlerësimit (tërësisht apo pjesërisht), për shkak të provave të pakontestueshme lidhur

me pronësinë, përdorimin dhe posedimin e saj herët në kohë, si dhe rezulton e provuar se ajo është ndërtuar herët në vitet 2003 – 2005, kur për subjektin e rivlerësimit nuk ka asnjë dyshim të arsyeshëm se mund të jetë përfshirë në veprimtari ku të ketë përfituar të ardhura apo të mira materiale, për shkak të ndonjë funksioni publik prej tij apo ndonjë veprimtarie tjetër.

Trupi gjykues çmon të vlerësojë në këtë kuadër edhe tërësinë e sjelljeve të subjektit, të cilat e kanë ndërlidhur atë me këtë pasuri deri në muajin shkurt të vitit 2008, e shpjeguar edhe më lart në këtë vendim, e çmon se tërësia e tyre është pasojë e veprimeve juridiko-civile të kryera nga institucione publike e marrëdhënie juridiko-civile private mes palëve, për të cilat ai ka mbetur i ndërruar, për shkak të një situatë që e lidhte atë në vitin 2002 me pasurinë truall, pjesë e kësaj marrëdhënieje juridiko-civile.

30.9 Lidhur me sinqeritetin e subjektit në këto deklaramë apo etika e tij në sjelljet dhe veprimet deri në vitin 2008 do të trajtohet në një vlerësim proporcional dhe objektiv në vlerësimin tërësor të kësaj çështjeje.

31. Në përfundim të vlerësimit të pasurisë, në raport me barrën e provës, shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaramë të vërteta e të sakta në deklaratën *Vetting*. Nga trupi gjykues nuk u evidentuan problematika lidhur me pasuri në pronësi ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht apo për deklaramë të pamjaftueshëm, të cilat mund ta penalizonin atë në kuptim të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

32. Nga vlerësimi i provave dhe shpjegimeve në raport me deklaratën *Vetting*, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Gentian Hamiti ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

33. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në përfundim, ky institucion ka dërguar në datën 31.10.2017 raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Gentian O. Hamiti.

34. Komisioni ka kryer gjithashtu edhe përditësimin e informacionit të dërguar nga institucione ligjzbatuese. Në përfundim ka administruar raportin e deklasifikuar të subjektit të rivlerësimit Gentian O. Hamiti, në të cilin konstatohej “*përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës*”.

35. Referuar një të dhënë të përcjellë nga vëzhguesi ndërkombëtar²⁸, trupi gjykues vëren se:

i) Nga dokumentacioni i dosjes është konstatuar një lidhje familjare ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit A. T. H., djali i xhaxhait të subjektit të rivlerësimit, i cili është shpallur fajtor me vendimin e formës së prerë nr. 90/1996, datë 16.10.1996, të Gjykatës Penale të Diktimit Janinë, dënuar me 18 vjet e 6 muaj burgim, për veprat penale, të cilat i korrespondojnë dispozitave penale të kohës (neneve 283/1 dhe 297 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë), privim të të drejtave politike për 3 vjet dhe dëbim të përjetshëm nga shteti grek.

ii) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Delvinë, me vendimin nr. ***, datë 23.5.1998, ka njohur pjesërisht vendimin penal të huaj me nr. ***, datë 16.10.1996, duke vendosur dënimin me 13 vjet burgim, i cili fillonte nga data 24.9.1995. Vendimi ka marrë formë të prerë. Pas këtij vendimi shtetasi A. H. ka vuajtur pjesën e mbetur të dënimit në Shqipëri.

²⁸ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 19.5.2023, të ONM-së, dosja e hetimit.

36. Bazuar në sa më sipër, vëzhguesi ndërkombëtar nëpërmjet opinionit shpjegon:

a) Katër nga pesë veprat për të cilat përcaktohet përgjegjësia penale e z. A. H. kanë të bëjnë me mbajtjen, shitjen, transportimin dhe importimin e narkotikëve.

b) Mbajtja, shitja, transportimi dhe importimi i narkotikëve janë vepra penale në Shqipëri në zbatim të neneve 283 dhe 283/1 të Kodit Penal, janë të përfshira në listën e veprave penale të pikës 1, neni 3 i ligjit nr. 10192/2009, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, si dhe referohen nga pika 15 e nenit 3 të ligjit nr. 84/2016 për të përcaktuar kategorinë e “personave të përfshirë në krimin e organizuar”. Vepra penale “Importimi i narkotikëve” nuk ishte parashikuar në Kodin Penal Shqiptar të asaj kohe. Kjo vepër penale është shtuar më vonë me ligjin nr. 8733, datë 24.1.2001.

c) Për veprat të cilat është shpallur fajtor, shtetasi A. H., sipas ligjit shqiptar, konsiderohet si person i përfshirë në krimin e organizuar, pasi kualifikohet sipas përcaktimeve ligjore të neneve 283 dhe 283/a të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, prandaj kontaktet me të janë relevante për qëllimin e kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimit të përgjithshëm për këtë procedurë rivlerësimi.

ç) Duke pranuar se ky subjekt rivlerësimi ka lidhje familjare me shtetasin A. H., si dhe disa lidhje interesi pas dënimit me vendim të formës së prerë të këtij të fundit – siç përcaktohet nga deklarata e subjektit të rivlerësimit në DPV-në e vitit 2004 dhe transaksioni i pasurisë në vitin 2008, sipas mendimit të ONM-së, me qëllim të evidentimit të rrethanave faktike të çështjes është e nevojshme të sqarohet më tej marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit me z. A. H. dhe të verifikohet nëse ka pasur ndonjë kontakt tjetër mes tyre, duke kërkuar informacionin e mëposhtëm:

- i) listën e plotë të telefonatave (përfshirë mesazhet tekst) nga shoqëritë e telefonisë celulare “***” sh.a. dhe “***” sh.a., për dy vitet e fundit, të kryera ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur A.H.;
- ii) të dhënat për statusin e regjistrimit të objektit (ndërtesë) të ngritur në truallin me sip. 300 m², zona kadastrale ***, me vendndodhje në Delvinë dhe kopjen e dosjes së regjistrimit, si dhe çdo dokument tjetër përkatës që Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) në Sarandë mund të administrojë për të dyja këto pasuri²⁹.

37. Bazuar në sa më sipër, vëzhguesi ndërkombëtar ka paraqitur dosjet penale, në kuadër të procesit të rivlerësimit të subjektit Gentian Hamiti, për të vlerësuar: (i) plotësinë e deklaratës së kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit, si dhe ekzistencën e kontakteve të subjektit me një person të përfshirë në krimin e organizuar; (ii) ndikimin e kësaj shtete në vlerësimin e përgjithshëm të procesit, që mund të konsiderohet si cenim i besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë.

38. Trupi gjykues i Komisionit pranoi gjetjen dhe *indiciet* e vëna në dispozicion nga vëzhguesi ndërkombëtar dhe kreu të gjitha veprimet hetimore të kërkuara e të nevojshme për verifikimin e kësaj shtete. Komisioni kërkoi³⁰ informacion në shoqëritë telefonike për të provuar kontaktet e subjektit të rivlerësimit apo bashkëshortes së tij me shtetasin A. H..

39. *** sh.a. informoi³¹ Komisionin mbi informacionin e kërkuar, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk janë të regjistruar në rrjetin *mobile* të kësaj shoqërie, ndërsa për shtetasin A. H. ka rezultuar se në emër të tij janë të regjistruar tre numra celularë. Shoqëria nuk ka vendosur në dispozicion informacion mbi skedarët e të dhënave për numrat celularë, bazuar në legjislacionin në fuqi për ruajtjen dhe administrimin e të dhënave të pajtimtarit.

²⁹ Trajtuar më sipër, sipas nënpikës 21.2, të pikës 21 të këtij raporti “Gjetje të tjera”.

³⁰ Shihni shkresat nr. *** prot., datë 1.6.2023 dhe nr. *** prot., datë 1.6.2023, dosja e hetimit.

³¹ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 21.7.2023, nga shoqëria “***” sh.a.

40. *** sh.a. ka informuar³² Komisionin se për shtetasit e kërkuar (subjekti i rivlerësimit Gentian Hamiti, bashkëshortja e tij Armida Moçka dhe shtetasi A. H.) ka numra telefonikë duke përcjellë në formë elektronike informacionin e kërkuar dhe komunikimet.

41. Në vijim të këtij informacioni, duke pasur parasysh qëllimin e verifikimeve nëse ka një lidhje mes subjektit Gentian Hamiti ose bashkëshortes së tij Armida dhe kushëririt A. H., të dhënat janë analizuar duke kombinuar numrin e telefonuesit me numrin e thirrur. Si rrjedhojë është konstatuar se mes periudhës korrik – shtator 2021 ka pasur disa komunikime telefonike mes z. Gentian Hamiti dhe një numër kontakti të shoqërisë “****” sh.p.k.

42. Pas verifikimit në regjistrin tregtar të QKB-së, ka rezultuar³³ se ekzistojnë të regjistruara dy subjekte tregtare të emëtuara “****”, me formë ligjore sh.p.k., njëra me NUIS ***³⁴, statusi “aktiv”, datë regjistrimi 3.1.2003, e cila ka si administrator shtetasin A. H. dhe ortakë me nga 50% të kuotave shtetasit A. H. dhe A. M., që prej krijimit të saj, dhe tjetra me NUIS ***, regjistruar me vendim gjykate në datën 28.7.2004, me status “pezulluar”, e cila ka pasur si ortak të saj shtetasit A. M., A. H. dhe A. H.

43. Në këto rrethana, subjektit të rivlerësimit iu kërkuar të shpjegojë më shumë lidhur me këto telefonata dhe qëllimin e tyre.

44. Lidhur me këtë konstatim, subjekti i rivlerësimit deklaroi: *“Nga emrat që janë përmendur më sipër, komunikime telefonike për periudhën korrik – shtator 2021, me sa më kujtohet, kam pasur me djalin e xhaxhait A. H.. Siç konstatohet, kjo periudhë i përket asaj të pandemisë së shkaktuar nga virusi Covid-19. Në këtë kohë, ai së bashku me familjen u prekën nga infeksioni, duke kaluar një periudhë të vështirë shëndetësore. Qëllimi i telefonatave ka qenë për shkaqe shëndetësore. I jam drejtuar edhe kompanisë “****” për të marrë informacion, por nuk kam pasur një konfirmim prej tyre, të cilën e gjeni bashkëlidhur prapësimeve”.*

45. Sipas informacionit të përcjellë nga shoqëria “****” sh. a. lidhur me numrat telefonikë të shtetasit A. H., u analizuan ato lidhur me thirrje hyrëse ose dalëse me numrat e regjistruar të shtetasve Gentian Hamiti dhe Armida Moçka pranë kompanisë “****”, por nuk rezultuan të dhëna.

46. Sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakte me shtetasin A. H. (kushëriri i tij) dhe si kontakti i fundit i vërtetuar mes tyre është akti ligjor i nënshkruar nga palët “Deklaratë Noteriale nr. *** rep.”, që mban datën 14.12.2009, marrëdhënie këto për shkak të marrëdhënies së posaçme mes tyre, porse nuk është konstatuar ndonjë vijueshmëri e këtyre marrëdhënieve.

47. Në vijim, vlerësuar këto marrëdhënie në kuadër të kreu V “Kontrolli i figurës”, konkretisht neni 37, verifikimi i saktë në të shkuarën dhe në të tashmen për çdo individ; verifikimi nëse ka tendenca kriminale për përfshirjen në krimin e organizuar; vlerësim i përgjithshëm nëse individët mund të vihen nën presion nga strukturat kriminale; kontrolli nëse ka qenë, është apo tenton të angazhohet fshehurazi, vetëm, në bashkëpunim, ose në përbërje të një organizate kriminale, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet në asnjë nga këto rrethana.

48. Në vijim, vlerësimi dhe kontrolli i figurës duhet bazuar në informacionet e disponuara, vlerësuar në mënyrë objektive në lidhje me rrethana që merren parasysh sipas pikave 5 dhe 6 të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, ndaj trupi gjykues i kërkon subjektit të rivlerësimit të shpjegojë në gjykimin e tij bazuar edhe në provat dhe faktet e administruara gjatë hetimit administrativ lidhur me marrëdhënien e tij me shtetasin A. H. në kuptim të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016 e nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, për të vlerësuar:

a) plotësinë e deklaratës së kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit, si dhe ekzistencën e kontakteve të subjektit të rivlerësimit me një person të përfshirë në krimin e organizuar;

³² Shihni shkresën nr. *** prot., datë 11.7.2023, dosja e hetimit.

³³ Aksesuar online, materiali gjendet i printuar në dosje.

³⁴ Shihni ekstraktin historik të gjendjes së regjistrimit për shoqërinë “****” sh.p.k., gjeneruar nga sistemi online datë 7.11.2023.

b) ndikimin e kësaj situate në vlerësimin e përgjithshëm të procesit, që mund të konsiderohet si cenim i besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë.

49. Lidhur me këtë konstatim, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar përpara trupit gjykues se: “Së pari, deklaroj se unë në këtë moment vihem në dijeni të faktit që në ngarkim të shtetasit shtetasi A. H. ka pasur një dënim penal dhe me të vërtetë jam i shokuar. Dua të sqaroj specifikisht se në përmbushje të detyrimeve të mia kushtetuese dhe ligjore, përpara dorëzimit të deklaratës së kontrollit të figurës, kam marrë informacionin e nevojshëm nga familja ime e origjinës, nëna ime, për mundësinë e përfshirjes në krimin e organizuar të ndonjë prej personave të përcaktuar në shtojcën 3 të ligjit nr. 84/2016. Nga nëna ime më është bërë me dije informacioni se në fisin tonë nuk ka ndonjë person të dënuar. Deklaroj se prej kohës kur kam përfunduar gjimnazin, pjesën më të madhe të kohës e kam kaluar larg qytetit të lindjes sime për shkak të ambicieve të mia për shkollim dhe studim. Provohet fakti se për periudhën 1998 – 2002 kam ndjekur studimet në Fakultetin Juridik pranë Universitetit të Tiranës. Gjithashtu, në vitet 2002 – 2005, përsëri në pjesën më të madhe të kohës kam vazhduar të jetoj në Tiranë, për shkak të ndjekjes së kurseve dhe studimeve të thelluara për provimin e Shkollës së Magjistraturës, me përjashtim të periudhës rreth 4-mujore kur kam punuar OPGJ pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Më pas, në muajin tetor të vitit 2005 kam ndjekur Shkollën e Magjistraturës, profili gjyqtar. Nga dekretet e Presidentit të Republikës së Shqipërisë provohet fakti se në datën 5.10.2007 jam dekretuar gjyqtar për kryerjen e stazhit profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, më pas jam emëruar në vitin 2009 gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe, në vijim, prej vitit 2013 dhe aktualisht i emëruar gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe i deleguar pranë Gjykatës së Apelit Administrativ. Pra, jeta ime, për shkak të shkollimit dhe të ushtrimit të profesionit, ka qenë larg qytetit të lindjes. Me shtetasin në fjalë nuk kam pasur asnjë raport, për shkak të diferencës së moshës dhe karaktereve të ndryshme. Kjo ka sjellë indiferencën time dhe mospasjen e ndonjë interesi për të marrë informacion në lidhje me jetën e tij. Sqaroj se nuk kemi pasur kontakte me njëri - tjetrin, përveç kontakteve sporadike/rastësore si ato të datës 11.2.2008, në të cilën është lidhur Kontrata e Shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.2.2008 dhe datë 14.12.2009, që është lidhur Deklarata Noteriale nr. *** rep., datë 14.12.2009. Këto takime kanë qenë rastësore/sporadike dhe i shtyrë nga insistimi i vëllait tim F. H., i cili ishte një nga investitorët e objektit të ndërtuar mbi truallin me sip. 300 m², si dhe një nga blerësit e pasurisë së paluajtshme të llojit truall me sip. 300 m². Kujtoj që gjatë kohës që kanë ndodhur këto kontakte sporadike, unë së bashku me vëllain dhe shtetasi A. H. jemi paraqitur në zyrën e noterit pranë të cilit janë kryer këto veprime noteriale, kemi qëndruar shumë pak minuta dhe jemi larguar secili në drejtimin e vet”.

50. Sa më sipër, subjekti i rivlerësimit, lidhur me vlerësimin e plotësimit të deklaratës për kontrollin e figurës, sipas shpjegimeve dhe deklarimeve të bëra më sipër, të cilat deklarohen se janë tërësisht të vërteta, ka kërkuar nga trupi gjykues që t’i çmojë ato edhe në raport me rrethanat lehtësuese të parashikuara në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016, të cilat vlerëson se gjejnë vend në situatën e tij si subjekt rivlerësimi. Sipas praktikës së mëparshme të Komisionit, konkretisht vendimit të formës së prerë nr. 191, datë 26.7.2019, por edhe vendimeve të tjera si: nr. 79, datë 22.11.2018; nr. 227, datë 17.1.2020; nr. 372, datë 22.4.2021.

51. Në përfundim, trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e dërguar nga AKSIK-ja, informacionet nga organet ligjzbatuese dhe dokumentacionin nga institucionet publike e private, si dhe dëgjoi shpjegimet e subjektit e administroi ato së bashku me dokumentacionin bashkëlidhur, arrin në përfundimin se subjekti ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi.

52. Nuk u provua që subjekti të ketë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, të jetë i përfshirë apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës e neneve 34-39 të kreut V të

ligjit nr. 84/2016. Lidhja e tij me shtetasin A. H. është një lidhje familjare/gjaku e afërt me subjektin e rivlerësimit, të cilin ai nuk ka zgjedhur të ketë kontakt e, për më tepër, nuk rezultoi të ketë marrëdhënie miqësore të vijueshme, por përkundrazi (edhe ato për shkak të marrëdhënies së posaçme janë të vitit 2009). Ajo që zë peshë në këtë vlerësim është marrëdhënia nëpërmjet shkëmbimit të favoreve apo përfshirja në veprimtari kriminale drejtpërdrejt apo tërthorazi, takime të vazhdueshme me të, apo persona të tjerë të përfshirë në grupe kriminale, rrethana të cilat në fakt nuk rezultuan të kenë ndodhur, përkundrazi, nga subjekti rezultoi se ai ka shmangur në vazhdimësi këtë kontakt/marrëdhënie e se edhe vetë stili i jetës dhe puna e ka distancuar atë tërësisht nga këto situata familjare, të gjendura për shkaqe objektive e natyrale.

53. Lidhur me vlerësimin e kësaj rrethane, në kuadër të vlerësimit etik e besimit të publikut, trupi gjykues çmon ta vlerësojë atë në vlerësimin tërësor të çështjes.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

54. Raporti i vlerësimit profesional³⁵ është hartuar mbi bazën e raportit të vlerësimit të përgatitur për periudhën 8.10.2013 – 8.10.2016 nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

55. Raporti është hartuar mbi përshkrimin dhe analizën e dokumenteve të vlerësimit profesional të gjyqtarit Gentian Hamiti, lidhur me 5 dosje gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, të dhëna nga burimet arkivore të KLGJ-së, si dhe të dhëna e *indicie* nga denoncimet lidhur me vendimmarrje të subjektit të rivlerësimit. Nga vlerësimi i akteve i janë kërkuar shpjegime subjektit për disa çështje në vijim.

56. Çështja administrative nr. * regjistri, datë 7.3.2014,** që i përket paditëses Sh. D., kundër të paditurve Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore Tiranë, me objekt “Njohjen e vërtetësisë së dokumentit Regjistri Themeltar i vjetërsisë në punë nr. ***, për sa i përket vjetërsisë në punë të paditëses për vitet 1990 e 1991. Njohjen e vërtetësisë së vërtetimit datë 24.12.2009, për sa i përket vjetërsisë së punës së paditëses për vitet 1990 dhe 1991. Detyrimi i palës së paditur të më lidhë pensionin e pleqërisë duke filluar që nga dita e lindjes së të drejtës”.

56.1 Nga përmbajtja e dosjes rezulton se fillimisht padia ishte paraqitur për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me vendimin nr. ***, datë 26.2.2014, kishte vendosur moskompetencën e saj dhe dërgimin e çështjes për kompetencë lëndore Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

56.2 Me vendimin gjyqësor nr. ***, datë 21.4.2014, gjyqtari Gentian Hamiti ka vlerësuar të bazuara në ligj kërkimet e paditëses duke vendosur: “*Pranimin e padisë. Detyrimin e palëve të paditura për të njohur vërtetësinë e dokumentit Regjistri Themeltar i vjetërsisë në punë nr. ***, për sa i përket vjetërsisë së punës së paditëses për vitet 1990 dhe 1991. Detyrimin e palëve të paditura për t’i paguar paditëses pensionin si nënë me shumë fëmijë nga dita që i ka lindur kjo e drejtë. Vendimi nr. ***, datë 21.4.2014, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është kundërshtuar nga pala e paditur DRSSH Tiranë, në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. ***, datë 23.9.2015, ka vendosur: “Prishjen vendimit nr. ***, datë 21.4.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Dërgimin e çështjes për rigjykim Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.* Gjykata Administrative e Apelit, ka vlerësuar se: “...nuk mund të shprehet për themelin e çështjes, pasi çmon se vendimi nr. ***, datë 21.4.2014, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është në shkelje të rregullimeve

³⁵ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 23.11.2021.

procedurale lidhur me kompetencën lëndore për shqyrtimin e kësaj çështjeje. Gjykata vëren se duke pasur parasysh përcaktimet e ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nenet 7, 8/a dhe 23, si dhe vendimin unifikues nr. 3, datë 28.4.2014, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, shqyrtimi i kësaj padie nuk mund të përfundohej nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe se nga ana e saj duhej të procedohej me veçimin e kërtimeve civile dhe dërgimin e tyre gjykatës kompetente. Si rezultat, vendimi i dhënë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka cenuar thellësisht vlefshmërinë e procesit dhe vendimit”.

56.3 Lidhur me këtë konstatim, mbi konkluzionin e arritur nga Gjykata Administrative e Apelit, referuar kompetencës lëndore në shqyrtimin e çështjes, i është kërkuar subjektit të rivlerësimit të parashtrijë qëndrimin e tij.

56.4 Në vijim, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: “Sqaroj se në çështjen gjyqësore nr. *** regjistri, datë 7.3.2014, kam çmuar se aktet e vjetërsisë në punë, sikurse regjistrat themeltarë të punonjësve, kanë qenë akte që krijoheshin dhe administroheshin nga organe me natyrë publike, në ushtrim të funksioneve të tyre. Për rrjedhojë, duke qenë të tilla si dhe nisur nga fakti se pala e paditur në gjykim është një organ publik, i cili vepron me këtë atribut (nxjerrjen e akteve administrative që disponojnë në lidhje me të drejtën e pensionit), atëherë mosmarrëveshja është e natyrës administrative. Ky kërkim nuk përbën një kërkim të mëvetësishëm të padisë, por është në funksion të zgjidhjes së themelit të saj, duke përfshirë edhe punën e kryer prej paditëses për periudhën 1990 –1991. Ky kërkim, i cili përbën vërtetimin e një fakti juridik, është vlerësuar se qëndron në themel të ndryshimit të një marrëdhënieje juridike administrative, e cila është marrëdhënia juridike që rrjedh nga pagimi i pensionit të paditëses. Në lidhje me këtë konkluzion, i referohem vendimit nr. *** i vendimit (***), datë 3.4.2018, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, në të cilin është arsyetuar se: Në vendimin nr. ***, datë 6.10.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit është marrë një interpretim i gabuar i dispozitave që lidhen me kompetencën lëndore të gjykatave në gjykimin e çështjeve. Për këtë shkak, ky vendim do të priset dhe çështja do të kthehet për rishqyrtim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues. Nga aktet që gjenden në fashikull rezulton se paditësja ka ngritur një padi përmes së cilës kundërshton vërtetësinë e akteve të vjetërsisë në punë, për shkak të pasaktësisë së tyre në lidhje me emrin e saj të shënuar në këto akte. Si pasojë e kësaj pasaktësie paditëses i është mohuar e drejta për pension të plotë pleqërie nga ana e palës së paditur. Gjykata e shkallës së parë, pasi e ka gjykuar çështjen ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, ndërkohë që Gjykata Administrative e Apelit ka disponuar me prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim, duke arsyetuar se kërkitimi për njohjen e pavërtetësisë së akteve të vjetërsisë në punë është një kërkim i natyrës civile. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë çmon se ky përfundim i Gjykatës Administrative të Apelit është i gabuar. Kërkitimi për deklarimin e pavërtetësisë së akteve të vjetërsisë në punë është një kërkim me natyrë administrative. Aktet e vjetërsisë në punë, sikurse kanë qenë regjistrat themeltarë të punonjësve, kanë qenë akte që krijoheshin dhe administroheshin nga organe me natyrë publike, në ushtrim të funksioneve të tyre. Për rrjedhojë, duke qenë të tilla, si dhe nisur nga fakti se pala e paditur në këtë gjykim është një organ publik, i cili vepron me këtë atribut (nxjerrjen e akteve administrative që disponojnë në lidhje me të drejtën e pensionit), atëherë mosmarrëveshja është e natyrës administrative. Të njëjtin qëndrim Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e ka mbajtur edhe në çështje të ngjashme. Në analizë të sa më sipër, nëse nga paditësja pretendohet njohja e vjetërsisë në punë, bazuar në dokumente për të cilat mund të pretendohet nga ana e paditur se kanë disa pasaktësi, edhe mosmarrëveshja e krijuar mes këtyre palëve për të rivendosur në vend të drejtën e pretenduar të shkelur nga paditësja, duhet gjykuar nga gjykatat administrative, sipas ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar. Korrigjimi apo saktësimi i të dhënave që përmbajnë aktet zyrtare, kërkon domosdoshmërisht shprehjen e vullnetit shtetëror të organit shtetëror, që i ka lëshuar këto akte ose të institucionit, i cili i administron ato, sikundër është në rastin konkret DRSSH

Durrës. Por, në të njëjtën kohë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson të theksojë se gjykatat në asnjë rast nuk duhet të ngatërrojnë zgjidhjen e themelit të çështjes (nëse dokumentet e pretenduara nga paditësi janë apo jo të vlefshme për të vërtetuar pretendimet për pasaktësi), me natyrën e konfliktit objekt gjykimi dhe gjykatën kompetente që duhet ta shqyrtojë atë. (shihni vendimin nr. ***, datë 17.12.2015, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë). Edhe nëse arsyetimi i Gjykatës Administrative të Apelit do të ishte i saktë, pra që kërkimet do të ishin të natyrës civile dhe administrative, atëherë do të ndodheshim përpara situatës së sanksionuar në vendimin unifikues nr. 3, datë 28.4.2014, në të cilin, ndër të tjera, përcaktohet se: Çështjet të cilat në objektin e tyre kanë disa kërkime si të natyrës civile dhe administrative, kërkime të cilat janë paraqitur përpara datës 4.11.2013, do të vazhdojnë të gjykojnë nga gjykata ku ato janë paraqitur. Duke qenë se padia është paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan në datën 10.7.2012, atëherë këto kërkime edhe për këtë shkak nuk mund të ndaheshin. Për çka u arsyetua më sipër, në rigjykim, Gjykata Administrative e Apelit, pasi të marrë në analizë pretendimet e ngritura nga paditësi në ankim, duhet ta shqyrtojë çështjen në themel dhe të japë vendim përfundimtar në lidhje me bazueshmërinë në ligj e në prova të padisë. Po kështu, i referohem dhe vendimit nr. *** i vendimit (***), datë 8.5.2018, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, e cila arrin në përfundimin se pala paditëse e ka ezauruar rekursin administrativ. Ankimi administrativ i ushtruar nga paditësi ka rezultuar i pafavorshëm dhe një mjet joefektiv në kuptim të nenit 13 të KEDNJ-së. Fakti që organi administrativ DRSSH Durrës (dega e përfitimeve) ka vendosur lënien në fuqi të vendimi nr. ***, datë 1.3.2013 të DRSSH Durrës të çon në përfundimin se paditësi tashmë nuk ka asnjë mundësi për ta zgjidhur konfliktin jashtëgjyqësisht, referuar në veçanti pjesës arsyetuese të tij, i cili nuk njeh si kohë të marrëdhënieve të punës atë të pretenduar nga paditësi sa referuar objektit të padisë. Në përfundim, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se vendimi nr. ***, datë 15.7.2014, i Gjykatës Administrative të Apelit duhet të priset dhe çështja t'i dërgohet asaj gjykate për rigjykim asaj gjykate me tjetër trup gjykues. Gjithashtu, i referohem edhe vendimit nr. *** të vendimit (***), datë 2.11.2020, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, në të cilin është arsyetuar se: Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit, në pjesën ku ka arsyetuar se kërkimi për njohjen e vërtetësisë së kohës së punës së kryer për periudhën 1990 – 1991, është një kërkim që nuk është i natyrës administrative dhe për këtë duhet të pushohet çështja, përbën një argumentim tërësisht abuziv nga ana e kësaj gjykate. Në rigjykim, Gjykata Administrative e Apelit duhet t'i përmbahet konkluzioneve të parashtruara më sipër në këtë vendim dhe ta gjykojë çështjen në themel, duke u dhënë përgjigje pretendimeve dhe prapësimeve të palëve. Për sa më sipër, çmoj se çështja gjyqësore nr. *** regjistri, datë 7.3.2014, është e natyrës administrative. Referuar rasteve praktike që kam cituar më sipër, të cilat nuk janë të vetmet, dua të theksoj se tashmë, është një praktikë e konsoliduar që çështje gjyqësore të kësaj natyre janë në lëndë shqyrtimi të gjykatave administrative”.

56.5 Trupi gjykues, nën frymën e zbatimit drejt të ligjit material e procedural nga subjektet e rivlerësimit, referuar nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, çmon se nga subjekti i rivlerësimit është përcaktuar drejt kompetenca lëndore për shqyrtimin e çështjes referuar praktikës së Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, që ka zgjidhur *pro futuro* kompetencën lëndore për paditë e njohjes në fushën e sigurimeve shoqërore³⁶, duke arritur në konkluzionin se dokumenti i arsyetuar më sipër nuk paraqet problematika në drejtim të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

DENONCIME/ANKESA

57. Në lidhje me subjektin e rivlerësimit Gentian Hamiti, në Komision janë paraqitur 9 denoncime, 3 nga të cilat i drejtohen njëherazi disa subjekteve, ndër tyre edhe subjektit të rivlerësimit dhe një ankesë nga ILDKPKI-ja. Komisioni ka analizuar dhe vlerësuar të gjitha denoncimet e paraqitura dhe ka kërkuar dokumentacion përkatësisht sipas rastit. Për disa

³⁶ Vendimi nr. ***, datë 7.5.2021, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, pikat 13, 23, 24 dhe 58.

denoncime që kanë paraqitur problematika i janë kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit dhe janë trajtuar më poshtë.

58. Denoncimi i shtetasit F. H.³⁷, i cili paraqitet kundrejt një subjekti tjetër rivlerësimi, por denoncuesi përmend edhe gjyqtarin Gentian Hamiti në lidhje me vendimin “Për marrjen e masës së sigurimit të padisë” në datën 8.8.2016. Denoncuesi pretendon se çështja i është caktuar me short gjyqtares S. Gj., por meqenëse denoncuesi e kishte kundërshtuar gjykimin e çështjes nga kjo gjyqtare, çështja i kaloi për gjykim subjektit të rivlerësimit Gentian Hamiti. Denoncuesi pretendon se vendimi është dhënë nga gjykata në mungesë të tij, përpara datës së caktuar për zhvillimin e saj. Gjithashtu, denoncuesi pretendon se pranë sekretarisë së gjykatës i janë dhënë dy vendime të njëjta në përmbajtje, por me gjyqtarë të ndryshëm, ndaj ky shtetas ngre pretendimin se nuk është zhvilluar seancë gjyqësore nga subjekti i rivlerësimit, por thjesht është marrë vendimi nga gjyqtarja S. Gj. dhe është formatuar në variantin përfundimtar.

58.1 Komisioni iu drejtua për informacion e dokumentacion Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë³⁸. Nga verifikimi i akteve të përcjella vërehet se kërkesa e denoncuesit për sigurimin e padisë është regjistruar me procesverbalin nr. *** prot., datë 1.8.2016. Me vendimin nr. ***, datë 3.8.2016, të Kryetarit të gjykatës, pas heqjes dorë të gjyqtares E. Ç. çështja i është caktuar gjyqtares S. Gj., e cila bazuar në nenet 72 e 73 të Kodit të Procedurës Civile, me kërkesën nr. *** prot., datë 4.8.2016, ka kërkuar miratimin e heqjes dorë nga gjykimi i çështjes. Në seancën gjyqësore të datës 4.8.2016, gjyqtarja S. Gj. ka zhvilluar seancë gjyqësore në prani edhe të denoncuesit, duke deklaruar heqjen dorë nga gjykimi i kërkesës për masën e sigurimit të padisë dhe shtyrjen e seancës pa përcaktim, deri në vendimmarrjen e Kryetarit mbi kërkesën e saj për heqjen dorë nga gjykimi. Në lidhje me këtë kërkesë, me vendimin nr. ***, datë 4.8.2016, Kryetari i Gjykatës është shprehur për pranimin e saj. Në datën 8.8.2016, në seancën gjyqësore të zhvilluar në dhomë këshillimi pa praninë e palëve, sipas pikës 3 të nenit 28 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, gjyqtari Gentian Hamiti ka vendosur rrëzimin e kërkesës për masën e sigurimit të padisë. Sipas verifikimeve në portalin gjykata.gov.al rezultoi se janë zhvilluar 2 seanca gjyqësore, ajo e datës 4.8.2016 me gjyqtare S. Gj. dhe seanca e datës 8.8.2016 me gjyqtar Gentian Hamiti.

58.2 Komisioni kërkoi nga subjekti i rivlerësimit të shpjegojë lidhur me pretendimet e denoncuesit në raport me veprimet procedurale të ndjekura prej tij. Në vijim, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *“Kërkesa e z. F. H. për sigurimin e padisë është vënë në lëvizje nëpërmjet procesverbalit nr. *** prot., datë 1.8.2016, të mbajtur nga kancelari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Sekretarisë Gjyqësore të kësaj gjykate. Në bazë të urdhrin nr. ***, datë 18.7.2016, të Kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë “Për gatishmërinë e gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për periudhën 1.8.2016 – 31.8.2016”, kjo çështje gjyqësore i ka kaluar gjyqtares E. C., e cila ka qenë gjyqtarja e gatshme në listën e gatishmërisë për periudhën 1 - 2 gusht 2016. Në lidhje me këtë çështje gjyqësore, gjyqtare E. Ç. ka dhënë dorëheqjen, e cila është miratuar me vendimin nr. ***, datë 3.8.2016, të Kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke vendosur, ndër të tjera me këtë vendim, që çështja gjyqësore t’i kalojë gjyqtares S. Gj., e renditur pas gjyqtares E. Ç. në listën e gatishmërisë bazuar në urdhrin nr. ***, datë 18.7.2016. Kjo e fundit ka caktuar seancën gjyqësore për shqyrtimin e kërkesës për sigurim padie në datën 4.8.2016. Në seancën gjyqësore të kësaj date, gjyqtarja S. Gj. ka vendosur shtyrjen e saj, duke konstatuar se ka shkak për heqje dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje gjyqësore. Pra, në këtë datë, gjyqtarja S. Gj. nuk ka disponuar me një vendim përfundimtar në lidhje me kërkesën për sigurim padie të z. F. H.. Po në datën 4.8.2016, gjyqtarja S. Gj. ka paraqitur kërkesën nr. *** prot., datë 4.8.2016, për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes. Në lidhje me këtë kërkesë për heqje dorë, me vendimin nr. ***, datë 4.8.2016, Kryetari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin e saj, si dhe kalimin e çështjes*

³⁷ Denoncimi nr. *** prot., datë 16.1.2020, dosja e denoncimeve.

³⁸ Shihni shkresat nr. *** prot., datë 13.11.2023 dhe nr. *** prot., datë 23.11.2023, dosja e hetimit.

*për shqyrtim gjyqtarit Gentian Hamiti, i renditur pas gjyqtares S. Gj., në listën e gatishmërisë, bazuar në urdhrin nr. ***, datë 18.7.2016. Pra, deri në datën 8.8.2016 nuk ka vendimmarrje në lidhje me kërkesën për sigurim padie të z. F. H.. Në këtë datë (8.8.2016), në seancën gjyqësore të zhvilluar në dhomë këshillimi pa praninë e palëve, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 28 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, gjyqtari Gentian Hamiti ka vendosur rrëzimin e kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë. Sa më lart, rezulton se janë zhvilluar dy seanca gjyqësore lidhur me sigurimin e padisë, njëra e datës 4.8.2016, e cila është shtyrë për shkak të paraqitjes së kërkesës për heqje dorë nga gjyqtarja e çështjes, dhe deri në vendimmarrjen e Kryetarit të Gjykatës për këtë kërkesë për heqje dorë, nuk është marrë vendim për pranimin apo refuzimin e kërkesës për sigurim padie. Ndërsa seanca e dytë është zhvilluar në datën 8.8.2016, ku gjyqtari Gentian Hamiti ka vendosur refuzimin e kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë. Nuk ekzistojnë 2 vendime të njëjta në përmbajtje dhe me gjyqtarë të ndryshëm, ashtu siç pretendon denoncuesi”.*

58.3 Trupi gjykues, pasi analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, shoqëruar me dokumentacionin ligjor provues, konstaton se pretendimet e denoncuesit mbetën të paprovuara, duke vlerësuar të marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit të rivlerësimit.

59. Ankesa³⁹ e paraqitur nga *-ja**

59.1 *** (në vijim ***), ka paraqitur ankesë kundrejt subjektit të rivlerësimit z. Gentian Hamiti, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, pasi marrjen e vendimit nr. *** (***) datë 28.2.2022, e konsideron në shkelje të rëndë të kuadrit ligjor. Sipas ***-së, gjyqtari Gentian Hamiti me vendimin nr. *** datë 28.2.2022, ka përfunduar çështjen gjyqësore duke vendosur pranimin e kërkesëpadisë në shkelje flagrante të parashikimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar dhe nr. 9637, datë 7.4.2005, i ndryshuar, si dhe provave të paraqitura në gjykim. *** pretendon se vendimmarrja e gjyqtarit Gentian Hamiti, kryesisht në zbatim të ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar, ka rënë ndesh me parimet dhe parashikimet ligjore në fuqi. Në disa procese gjyqësore, gjyqtari Gentian Hamiti ka marrë vendime në shkelje flagrante të ligjit, në lidhje me situata faktike të provuara me dokumentacion justifikues ligjor, të cilat përbëjnë provë të plotë, për sa i përket procedurës administrative të kryer nga ana e institucionit. Gjithashtu, i njëjti gjyqtar nuk ka mbajtur të njëjtin qëndrim nga ana procedurale për vendimmarrje analoge. Në ankesën e saj, ndër të tjera, ***-ja citon: “*Në procesin gjyqësor ***-ja ka paraqitur dokumentacionin ligjor në lidhje me procedurën administrative të kryer, duke provuar se procedura administrative ka nisur me urdhrin nr. ***, datë 18.2.2021, të *** të ***-së. Në kuptimin procedural të ligjit shkelja është konstatuar në datën 21.5.2021, gjatë procedurës administrative të kryer, sipas shkresës nr. *** prot., datë 21.5.2021, të Agjencisë *** dhe, duke e konsideruar këtë shkresë si datën e konstatimit të shkeljes, ***-ja ka marrë masën administrative me vendimin nr. ***, datë 7.10.2021”.*

59.2 Në vlerësim të kësaj ankese, Komisioni, referuar parashikimeve të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në veçanti nenit 53, “Pjesëmarrja e publikut në denoncimin e fakteve”, mori në shqyrtim pretendimet e ngritura nga ***-ja, duke arsyetuar sa vijon:

a) Sipas nenit 109/b të Kodit të Procedurave Administrative parashikohet se: “*Një akt administrativ është i paligjshëm nëse është rezultat i shkeljes së dispozitave lidhur me procedurën administrative*”. Pjesë e procedurës administrative janë edhe afatet e shqyrtimit të kundërvajtjes administrative.

b) Në nenin 17 të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, në të cilin është parashikuar afati i shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative, në çështjet që shqyrtohen nga inspektoratet, të referon në ligjin e posaçëm.

c) Në nenin 25/1, pika 5 e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar,

³⁹ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 28.3.2022, të ILDKPKI-së.

është parashikuar se: “Kontrolli i plotë dhe hetimi administrativ i kryer nga Inspektorati i Lartë përfundon brenda 6 muajve pas fillimit të tij, i cili mund të zgjatet në përputhje me kërkesat e Kodit të Procedurave Administrative”. Gjithashtu, referuar pikës 5 të nenit 44 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, parashikohet se shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative të konstatuara gjatë kryerjes së inspektimeve të *** bëhet jo më vonë se 6 muaj pas konstatimit të shkeljes.

ç) Nga dokumentacioni që ***-ja përcjell nuk paraqitet asnjë akt i këtij organi publik për zgjatje të afatit të procedurës administrative, tej afatit të parashikuar nga ligji.

d) ***-ja, në urdhrin nr. ***, datë 18.2.2021, për kontrollin e plotë të deklaratave të interesave privatë të subjektit A. Zh., përcakton se “Veprimet që kanë të bëjnë me verifikimet e vërtetësisë, kontrollin aritmetik e logjik, duhet të kryhen deri në datën 19.8.2021”, pra brenda një afati 6-mujor.

dh) Gjykata ka konstatuar kalimin e afatit 6-mujor, ndërmjet urdhrit nr. ***, datë 18.2.2021 dhe vendimit nr. ***, datë 17.10.2021 për ndëshkimin administrativ dhe, për këtë shkak, ka vendosur pranimin e padisë.

e) Në lidhje me pretendimin për qëndrime të ndryshme nga ana procedurale të gjyqtarit, për vendimmarrje analoge, Komisioni vlerëson se bazuar në nenin 71 dhe në pikën 4 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, ankesa e ***-së lidhet me vlerësimin e themelit të çështjeve të shqyrtuara nga subjekti i rivlerësimit, i cili, parë edhe në këndvështrimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë⁴⁰ konsiston në gjykimin e mosmarrëveshjes nga gjykata mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet.

59.3 Sa më sipër, Komisioni ka kërkuar nga subjekti të paraqesë qëndrimin e tij mbi pretendimet e parashtruara nga ankuesi dhe, në vijim, subjekti ka parashtruar: “Në lidhje me pretendimin e ***-së, se gjyqtari Gentian Hamiti me vendimin nr. ***, datë 28.2.2022, ka përfunduar çështjen gjyqësore duke vendosur pranimin e kërkesëpadisë në shkelje flagrante të parashikimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar dhe nr. 9637, datë 7.4.2005, i ndryshuar, si dhe provave të paraqitura në gjykim, shpjegoj dhe çmoj se vendimi është marrë në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, si dhe nenit 18 të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Për zgjidhjen e kësaj çështjeje gjyqësore, referenca ka qenë në kreun II të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, në të cilin janë parashikuar dispozitat që kanë të bëjnë me procedurat e konstatimit dhe të shqyrtimit të kundërvajtjes administrative. Në nenin 17 të këtij ligji është parashikuar afati i shqyrtimit të kundërvajtjes administrative. Kjo dispozitë ka vendosur afate të prera për shqyrtimin e kundërvajtjes administrative, mosrespektimi i të cilave sjell humbjen e të drejtës për të shqyrtuar kundërvajtjen administrative. Në pikën 1 të saj parashikohet rregulli i përgjithshëm se shqyrtimi i kundërvajtjes administrative bëhet brenda 30 ditëve nga data e konstatimit të saj, por jo më vonë se 6 muaj pas kryerjes së kësaj kundërvajtjeje, ndërsa në pikën 2 të kësaj dispozite janë sanksionuar rastet përjashtimore për të cilat: (a) kompetente për shqyrtimin e kundërvajtjes është gjykata; (b) ligji i veçantë ka parashikuar afate të ndryshme; (c) konstatimi i shkeljeve bëhet nga struktura auditimi apo inspektimi. Në rastin për të cilin më kërkohet shpjegim, jemi para rastit përjashtimor të parashikuar në shkronjën “c” të pikës 2 të nenit 17 të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, pasi ***-ja është një strukturë inspektimi, që funksionon në bazë të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”. Për rrjedhojë, afatet e përcaktuara në pikën 1 të nenit 17 të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, janë llogaritur prej meje nga data e nisjes së inspektimit/kontrollit të ushtruar ndaj subjektit. Po kështu, këto afate dhe procedura

⁴⁰ Vendimi nr. ***, datë 30.10.2012, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

rregullohen nga ligji i posaçëm, i cili ka qenë ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, si dhe ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”. Në pikën 4 të nenit 40 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, parashikohet se shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative të konstatuara gjatë kryerjes së inspektimeve të *** bëhet jo më vonë se 6 muaj pas konstatimit të shkeljes. Ndërsa në nenin 44 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” parashikohet se shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative të konstatuara gjatë kryerjes së inspektimeve të Inspektoratit të Lartë, bëhet jo më vonë se 6 muaj pas konstatimit të shkeljes. Kam vlerësuar se duke iu referuar si datës së urdhrit nr. ***, datë 18.2.2021, të Inspektorit të Përgjithshëm të ***-së, për kontrollin e deklaratave të interesave privatë të paditësit, ashtu dhe datës së shkresave të organeve publike/bankave të nivelit të dytë (pasqyruar në përmbajtjen e vendimit nr. ***, datë 7.10.2021), në bazë të të cilave prezumohet (prezumim i thjeshtë ligjor) konstatimi/marrja djepi e kundërvajtjes administrative, si dhe datës së nxjerrjes së vendimit, objekt gjykimi, arrihet në konkluzionin se ky vendim është nxjerrë tej afatit 6-mujor të sanksionuar në pikën 1 të nenit 17 të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, si dhe pikën 4 të nenit 40 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 dhe pikën 5 të nenit 44 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005. Ashtu si ndjekja penale dhe ekzekutimi i vendimeve penale karakterizohet nga afate parashkrimi, ashtu dhe kundërvajtja administrative normohet nga ky institut ligjor. Kam çmuar se mosrespektimi i afatit ligjor ka sjell humbjen e të drejtës për të shqyrtuar kundërvajtjen administrative nga ***-ja. Afati për shqyrtimin e kundërvajtjes administrative është i prerë dhe shkelja e tij shkakton humbjen e të drejtës së shqyrtimit të kundërvajtjes administrative. Ky afat shqyrtohet nga gjykata edhe kryesisht, sipas pikës 7 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Edhe pse ky afat është i prerë dhe, si i tillë, për të nuk mund të lejohet ndërprerja, pezullimi apo zgjatja e tij, sërish ***-ja nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim administrativ për zgjatjen e afatit 6-mujor të shqyrtimit të kundërvajtjes administrative, bazuar në pikën 5 të nenit 25/1 të ligjit nr. 9049/2003. Po kështu, kjo zgjatje afati nuk është bërë duke u bazuar në nenin 92 të Kodit të Procedurave Administrative. Në respektim të detyrimeve procedurale të përcaktuara në pikën 1 të nenit 35 të ligjit nr. 49/2012, datë 3.5.2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” ***-ja nuk ka provuar para gjykatës ligjshmërinë e aktit administrativ, të nxjerrë jo me kërkesë të paditësit, si dhe faktet se ai ka parashtruar dhe ka vënë në themel të veprimtarisë së kundërshtuar në gjykatë. Konkretisht, ***-ja nuk ka provuar respektimin e afatit 6-mujor të sanksionuar në pikën 1 të nenit 17 të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, pikën 4 të nenit 40 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 dhe pikën 5 të nenit 44 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, i cili është një afat i prerë, që merret kryesisht nga gjykata. Për sa më sipër, kam vlerësuar se ***-ja e ka humbur të drejtën për të shqyrtuar kundërvajtjen administrative, pasi ka kaluar afati 6-mujor, i sanksionuar në pikën 1 të nenit 17 të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, pikën 4 të nenit 40 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 dhe pikën 5 të nenit 44 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005.

Bëj me dije se këtë ankim ***-ja e ka adresuar dhe tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i cili me vendimin nr. *** prot., datë 27.12.2023, ka vendosur: “Arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së ***-së, regjistruar pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. *** prot., datë 29.4.2022, ndaj vendimmarrjes së gjyqtarëve A. S., Gentian Hamiti dhe G. M., gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, si gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”.

Me këtë vendim, Inspektori i Lartë i Drejtësisë arsyeton se: Në vendimmarrjet e paraqitura në ankesë nuk rezulton të jemi para asnjë prej rasteve, të cilat parashikohen si shkelje disiplinore sipas nenit 102, pika 2, shkronja “a” e ligjit nr. 96/2016, i sipërcituar, pasi rezultojnë të jenë vendime të formës së prerë. Nga ana tjetër nuk rezulton që në vendimmarrje të jetë cenuar një

dispozitë ndaluese e ligjit, e cila në çfarëdolloj rrethane nuk do të kishte nevojë për konstatim nga një gjykatë më e lartë, nëse do të ishte dukshëm e shkelur apo e cenuar nga gjyqtari në vendimmarrjen e vet, sjellje të cilat do të cenonin figurën dhe pozitën e gjyqtarit në ushtrimin e detyrës dhe që mund të justifikonin një kontroll të vendimit përtej kontrollit mbi bazë apelimi gjyqësor. Për rrjedhojë, pretendimet e ankuesit për vlerësim të provave dhe shkelje të ligjit të aplikueshëm apo dhe standarde të dyfishta nuk pasqyrojnë fakte, apo indicie të mjaftueshme të cilat të krijojnë dyshimin e arsyeshëm për kryerjen e shkeljes disiplinore, për sa kohë rezultojnë të jetë kryer një vlerësim dhe analizë e pavarur e provave dhe kuadrit ligjor në fuqi me të njëjtin qëndrim të secilit gjyqtar në secilën prej çështjeve të gjykuara prej tij, e për këtë shkak ato duhet të arkivohen... Pra, dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk ka konstatuar shkelje disiplinore sipas nenit 102, pika 2, shkronja "a" e ligjit nr. 96/2016, si dhe nuk ka konstatuar shkelje të ndonjë dispozite ndaluese të ligjit, sjellje të cilat do të cenonin figurën dhe pozitën e gjyqtarit në ushtrimin e detyrës dhe që mund të justifikonin një kontroll të vendimit përtej kontrollit mbi bazë apelimi gjyqësor.

*Për sa i përket pretendimit të ***-së për qëndrime të ndryshme nga ana procedurale të gjyqtarit, për vendimmarrje analoge, sqarohet se ky është një pretendim tërësisht i pabazuar. Përkundrazi, përherë kam aplikuar standarde të njëjta në vendimmarrje, bazuar në parimin e sigurisë juridike. Për sa më sipër vlerësoj se në tërësi pretendimet e ***-së janë të pabazuara në kuadrin ligjor të sipërcituar për trajtimin e kësaj çështjeje, si dhe në provat shkresore që vetë kjo palë ka paraqitur pranë gjykatës”.*

59.4 Trupi gjykues, në vlerësim të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, fakteve e rrethanave të sipërcituara, bazuar në dokumentacionin ligjor provues, çmon se në lidhje me shkaqet e ankesës së paraqitur nga ***-ja, qëndrimi i gjyqtarit Gentian Hamiti duket se është në përputhje dhe me qëndrimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i cili ka arsyetuar: Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë që, ashtu sikurse në procedimin penal apo atë disiplinor, edhe në procedimin administrativ, subjekti nuk mund të procedohet dhe të ndëshkohet me dënime administrative për shkelje administrative të kryera përtej afatit që parashikon ligji për ndjekjen dhe ndëshkimin e tyre⁴¹.

60. Denoncimi i shtetases T. P., e cila pretendon se subjekti i rivlerësimit, gjyqtari Gentian Hamiti, ka nxjerrë një vendim në datën 15.11.2021, pa njoftim paraprak të palëve të interesuara, duke vendosur pushimin e gjykimit të çështjes administrative.

60.1 Komisioni kërkoi⁴² nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dosjen e çështjes dhe vendimin e dhënë nga subjekti i rivlerësimit, e cila informon se⁴³ çështja me palë paditëse T. P., të paditur noterit publik F. L. dhe personi i tretë D. L., me objekt: Pavlefshmëri absolute të aktit noterial për refuzimin e lëshimit të Dëshmisë së Trashëgimisë Testamentare dhe deklarimin e pavlefshëm të testamentit nr. ***, datë 22.5.2021, është shqyrtuar pranë kësaj gjykate nga gjyqtar Gentian Hamiti, i cili me vendimin nr. ***, datë 11.11.2021, ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes administrative nr. regj. them. *** (***), datë regjistrimi 20.10.2021.

60.2 Nga informacioni i përcjellë rezultojnë se ndaj vendimit nr. ***, datë 11.11.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, pala paditëse T. P. ka paraqitur ankim dhe dosja gjyqësore është dërguar për shqyrtim pranë Gjykatës Administrative të Apelit, nga e cila nuk ka ende një vendimmarrje mbi ankimin e paraqitur.

60.3 Referuar vendimit nr. ***, datë 11.11.2021, të subjektit të rivlerësimit, rezultojnë se në datën 22.5.2021 shtetasi B. K. i ka kërkuar noterit publik F. L. të redaktojë testamentin në lidhje me pasurinë e tij. Me testamentin nr. 993, datë 22.5.2021, të noterit publik F. L., testatori ka shprehur vullnetin të emërojë si trashëgimtare testamentare mbas vdekjes bashkëjetuesen e

⁴¹ Vendim nr. ***, datë 24.2.2016, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

⁴² Shihni shkresën nr. *** prot., datë 16.1.2024.

⁴³ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 29.1.2024.

tij T. P.. Në vijim, znj. A. K., vajza e testatorit B. K., ka depozituar te noteri publik F. L. dy kërkesa, me të cilat ka kërkuar çeljen e dëshmisë së trashëgimisë testamentare, si dhe çeljen e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin B. K.. Në datën 13.7.2021, noteri publik F. L. ka vendosur “Çeljen e procesverbalit të testamentit nr. ****”. Po kështu, noteri ka marrë edhe “Vendimin për refuzimin e lëshimit të Dëshmisë së Trashëgimisë Testamentare”, me të cilin është shpallur i pavlefshëm testamenti nr. ***, datë 22.5.2021. Me vendimin nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.7.2021, noteri ka vendosur: Pranimin e kërkesës, lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin B. K., duke përcaktuar si trashëgimtare ligjore të radhës së parë të tij: 1. A. K., e bija, e cila në zbatim të nenit 361 të Kodit Civil do të trashëgojë të gjithë pjesën e pasurisë trashëgimore dhe po në këtë raport do të përgjigjet për të gjitha detyrimet që rëndojnë mbi këtë pasuri trashëgimore (neni 341 i Kodit Civil). Në këto kushte, paditësja i është drejtuar gjykatës duke pretenduar sipas objektit të kërkesëpadisë.

60.4 Referuar vendimit gjyqësor të gjyqtarit Gentian Hamiti rezulton se në seancën përgatitore të datës 25.10.2021, gjykata, bazuar në përmbajtjen e vendimit të noterit publik, ka konstatuar se nga paditësja T. P. nuk është rregulluar drejt bashkëndërgjyqësia e detyrueshme⁴⁴, pasi nuk ka thirrur në cilësinë e palës së paditur shtetasen A. K., që rezulton të jetë trashëgimtare ligjore e radhës së parë e të ndjerit B. K.. Për këtë qëllim, palës paditëse i është lënë afat nga gjykata për të rregulluar drejt bashkëndërgjyqësinë e detyrueshme deri në datën 11.11.2021⁴⁵. Gjkata, në seancën përgatitore të datës 11.11.2021, pasi ka konstatuar se nga ana e paditëses T. P. nuk është rregulluar bashkëndërgjyqësia e detyrueshme brenda afatit të caktuar prej saj, bazuar në nenin 161, shkronja “ç” e Kodit të Procedurës Civile, ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes.

60.5 Sa më sipër, rezulton se çështja nr. *** është regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë në datën 20.10.2021. Brenda afatit 5-ditor nga paraqitja e kërkesëpadisë në gjykatë, në seancën përgatitore të datës 25.10.2021, gjykata ka konstatuar se nga denoncuesja nuk është rregulluar drejt bashkëndërgjyqësia e detyrueshme, duke i lënë asaj afat për rregullimin e ndërgjyqësisë deri në datën 11.11.2021. Për shkak të mosrregullimit të bashkëndërgjyqësisë së detyrueshme nga denoncuesja brenda afatit të caktuar nga gjykata, në datën 11.11.2021 është marrë vendimi për pushimin e gjykimit të çështjes bazuar në nenin 161, shkronja “ç” dhe nenin 154/a të Kodit të Procedurës Civile.

60.6 Komisioni ka arritur në konkluzionin se për shkaqet e përmendura më sipër duket se kërkesëpadia e paraqitur nga denoncuesja ka mbetur pa veprime të mëtejshme nga gjykata.

60.7 Për këto shkaqe, është kërkuar nga subjekti të japë shpjegime dhe të paraqesë akte provuese lidhur me veprimet procedurale të ndjekura gjatë shqyrtimit të çështjes, disponimin për vendime të ndërmjetme, si dhe mbi pretendimin e denoncueses për mosnjoftimin paraprak të palëve, duke vendosur pushimin e gjykimit të çështjes.

60.8 Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur qëndrimin e tij, shoqëruar me aktet provuese: “Në datën 21.10.2021, nëpërmjet shortit elektronik, jam caktuar gjyqtari i shqyrtimit të çështjes administrative nr. regj. them. *** (***), datë regjistrimi 20.10.2021. Në objektin e kërkesëpadisë, një nga kërkimet e paditëses ka qenë edhe marrja e masës së sigurimit të padisë: pezullimi i efekteve të vendimit të Dëshmisë së Trashëgimisë Ligjore për pasurinë nr. ***, ndodhur në z. k. nr. ***, vol. *** dhe f. ***, në rrugën “****” p. ***, shk. ***. k. ***, ap. ***, Tiranë, në ASHK-në Tiranë deri në përfundim të gjykimit. Kjo kërkesë për sigurim padie, për shkak të ngutshmërisë së saj, është shqyrtuar brenda afatit 5-ditor të sanksionuar në pikën 3 të nenit 28 të ligjit nr. 49/2012. Konkretisht, me vendimin e datës 25.10.2021, Gjkata

⁴⁴ Gjkata i referohet nenit 161 të Kodit të Procedurës Civile, në të cilin parashikohet bashkëndërgjyqësia e detyrueshme.

⁴⁵ Referuar shkronjës “ç” të nenit 161 të Kodit të Procedurës Civile: “Nëse vendimi nuk mund të jepet përveçse kundrejt shumë personave, në rastin e bashkëndërgjyqësisë së detyrueshme, këta të fundit duhet të thirren si të paditur në të njëjtin proces. Gjyqtari, kur konstaton se bashkëndërgjyqësia e detyrueshme në anën e të paditurve është e paplotë, i lë palës paditëse një afat deri në 20 ditë që ta rregullojë atë, sipas shkronjës “c” të këtij neni dhe nenit 154/a të këtij Kodi. Në rast se paditësi nuk vepron brenda afatit të mësipërm, gjykata vendos pushimin e gjykimit”.

Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur: (1) Refuzimin e kërkesës për sigurim padie. (2) Kundër këtij vendimi lejohet ankimi i veçantë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, duke filluar nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

*Pas shqyrtimit të kësaj kërkesë të natyrës së veçantë është konstatuar në seancën përgatitore të datës 25.10.2021, se nga paditësja nuk është rregulluar drejt bashkëndërgjyqësia e detyrueshme, pasi, kjo palë ndërgjyqëse nuk ka thirrur në cilësinë e palës së paditur shtetasen A. K., e cila është trashëgimtare ligjore e radhës së parë e të ndjerit B. K.. Për këtë, bazuar në nenin 161 të Kodit të Procedurës Civile, është marrë vendim i ndërmjetëm datë 25.10.2021, me të cilin i është lënë afat paditëses deri në datën 11.11.2021 (pra, rreth 17 ditë), për të rregulluar drejt bashkëndërgjyqësinë e detyrueshme. Për këtë vendim të ndërmjetëm është njoftuar përfaqësuesja ligjore e paditëses, pajisur me prokurë të posaçme të datës 8.11.2021, avokate S. T., fakt i cili provohet me fletëthirrjen e datës 25.10.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Nga përmbajtja e kësaj fletëthirrjeje rezulton se përfaqësuesja ligjore e paditëses, avokate S. T., ka marrë dijeni për vendimin e ndërmjetëm për rregullimin e drejtë të bashkëndërgjyqësisë së detyrueshme, në datën 26.10.2021, pasi kjo fletëthirrje është nënshkruar prej saj, çka prezumon dijeninë. Në seancën përgatitore të datës 11.11.2021, nga ana e paditëses apo përfaqësueses së saj ligjore, edhe pse kjo e fundit ka pasur dijeni rregullisht, si për datën e seancës gjyqësore ashtu edhe për detyrimin procedural për rregullimin e bashkëndërgjyqësisë së detyrueshme, nuk është rregulluar drejt bashkëndërgjyqësia e detyrueshme, duke kërkuar thirrjen si palë të paditur të shtetasen A. K., e cila është trashëgimtare ligjore e radhës së parë e të ndjerit B. K.. Duke qenë se paditësja nuk ka rregulluar drejt bashkëndërgjyqësinë e detyrueshme, brenda afatit të caktuar nga gjykata, atëherë është vendosur pushimi i gjykimit, bazuar në shkronjën “ç” të nenit 161 të Kodit të Procedurës Civile, në të cilën parashikohet: “ç) Nëse vendimi nuk mund të jepet përveçse kundrejt shumë personave, në rastin e bashkëndërgjyqësisë së detyrueshme, këta të fundit duhet të thirren si të paditur në të njëjtin proces. Gjyqtari, kur konstaton se bashkëndërgjyqësia e detyrueshme në anën e të paditurve është e paplotë, i lë palës paditëse një afat deri në 20 ditë që ta rregullojë atë, sipas shkronjës “c” të këtij neni dhe nenit 154/a të këtij Kodi. Në rast se paditësi nuk vepron brenda afatit të mësipërm, gjykata vendos pushimin e gjykimit. Ky vendim pushimi është vendosur me vendimin nr. ***, datë 11.11.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Në këtë çështje gjyqësore, vlerësoj se kam respektuar standardet e procesit të rregullt gjyqësor, fillimisht duke shqyrtuar kërkesën për sigurim padie brenda afatit 5-ditor të sanksionuar në pikën 3 të nenit 28 të ligjit nr. 49/2012, më pas është njoftuar paditësja nëpërmjet përfaqësueses së saj ligjore të pajisur me prokurë të posaçme, për rregullimin e bashkëndërgjyqësisë së detyrueshme konform nenit 161 të Kodit të Procedurës Civile, duke i dhënë dhe kohën e nevojshme, të arsyeshme për të bërë këtë rregullim. Për shkak se paditësja nuk ka vepruar duke përmbushur detyrimet procedurale, atëherë është vendosur pushimi i gjykimit. Për sa më sipër, mendoj se veprimet procedurale të kryera prej meje janë në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës, dispozitat e ligjit nr. 49/2012, si dhe Kodin e Procedurës Civile.*

*Më lejoni të shtoj se paditësja ka paraqitur ankimi pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, ndaj vendimit nr. ***, datë 11.11.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me të cilin është vendosur pushimi i gjykimit të çështjes administrative nr. regj. them. *** (***) , datë regjistrimi 20.10.2021. Në datën 23.11.2023, znj. T. P. ka paraqitur kërkesë për heqje dorë nga ankimi duke kërkuar dhe pushimin e gjykimit. Me vendimin nr. *** (***) , datë 2.2.2024, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur: Pushimin e shqyrtimit të çështjes nr. *** (***) regjistri themeltar, datë 2.2.2022, në Gjykatën Administrative të Apelit, për shkak të heqjes dorë nga ankimi nga pala ankuese T. P.”*

60.9 Trupi gjykues, në vlerësim të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit provues të paraqitur prej tij, konstaton se pretendimet e denoncuesit mbeten të paprovuara, duke vlerësuar të marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit të rivlerësimit.

61. Nga disa *indicie* të marra nga burime të hapura⁴⁶ është konstatuar se në vitin 2019 ish-Zëvendëskryeministri i Shqipërisë, z. E. B., ka diskutuar/akuzuar publikisht subjektin e rivlerësimit Gentian Hamiti, i cili ka marrë vendim për pezullimin e veprimeve administrative për bllokimin e aktivitetit, të vendosur nga organet tatimore për kompleksin “****”, pasi gjatë kontrollit administrativ të kryer në kuadër të aksionit kundër informalitetit, nga organi tatimor u konstatua se nuk kishte lëshuar kupon tatimor.

61.1 Komisioni kërkoi⁴⁷ informacion dhe dokumentacion nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë mbi vendimin e dhënë nga subjekti i rivlerësimit, për të verifikuar nëse ka ndonjë vendimmarrje nga një gjykatë më e lartë në vazhdimësi të tij.

61.2 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë informon⁴⁸ se pranë saj janë shqyrtuar dy çështje gjyqësore me palë ndërgjyqëse shoqërinë “****” sh.p.k. dhe gjyqtar subjektin e rivlerësimit Gentian Hamiti:

i) Çështja nr. **, regjistruar në datën 30.6.2017**, me objekt anulim të aktit administrativ, me palë paditëse shoqërinë “****” sh.p.k. dhe të paditur Drejtorinë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj, për të cilën subjekti i rivlerësimit me vendimin nr. ***, datë 22.9.2017, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë të shoqërisë “****” sh.p.k.

ii) Çështja nr. **, regjistruar në datën 6.8.2019**, me objekt “Marrjen e masës së sigurimit të padisë”, me palë kërkuese shoqërinë “****” sh.p.k. dhe person i tretë “Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë”, shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit Gentian Hamiti, i cili me vendimin nr. ***, datë 7.8.2019, ka vendosur pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë dhe pezullimin e veprimit administrativ. Referuar të dhënave më sipër, të marra nga burime të hapura, rezulton se ato i referohen kësaj çështjeje gjyqësore, ndaj Komisioni hetoi⁴⁹ lidhur me vijimësinë e saj, nga ku rezultoi se:

61.3 Ndaj vendimit gjyqësor nr. ***, datë 7.8.2019, të marrë nga subjekti i rivlerësimit, personi i tretë “Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë” ka paraqitur ankim në Gjykatën Administrative të Apelit. Ankimi është shqyrtuar nga Gjykata administrative e Apelit, e cila, bazuar në nenin 50 të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, me vendimin nr. *** (***) datë 9.2.2023, ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes me arsyetimin se: *Gjykata Administrative e Apelit çmon se vendimi datë 7.8.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në kohën e dhënies së tij, është marrë në përputhje me ligjin procedural dhe atë material, si dhe rezulton i bazuar në prova dhe ai do të duhej të lihej në fuqi sipas nenit 50/b të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar. Megjithatë, Gjykata Administrative e Apelit ka konstatuar se: Nga verifikimi i kryer nëpërmjet sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, rezulton se shoqëria “****” sh.p.k. ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurve Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë dhe Drejtoria e Apelit Tatimor pranë Ministrisë së Financave me objekt: Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të njoftimvlerësimit për detyrimet tatimore nr. ***, datë 30.9.2019, të Drejtorisë së Apelit Tatimore, akt me të cilin lidhet kërkesa për marrjen e masës së sigurimit, vendimi për të cilën është objekt shqyrtimi në rastin konkret. Nga verifikimi ka rezultuar se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 16.12.2019, ka vendosur rrëzimin e padisë, heqjen e masës së sigurimit të padisë të marrë nga gjykata me vendim të ndërmjetëm të datës 7.8.2019. Ndaj këtij vendimi nuk mund të ushtrohet ankim dhe se ai është vendim i formës së prerë⁵⁰. Në këto kushte, nga sa rezulton më lart, gjykimi në themel i padisë është përfunduar me vendim të*

⁴⁶ https://www.cna.al/2019/08/07/gjykata-liron-****-in-rebelohet-e.-b.-copton-gjyqtarin-hamiti/

⁴⁷ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 16.1.2024.

⁴⁸ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 29.1.2024.

⁴⁹ Shihni vendimin nr. ***, datë 9.2.2023, nga verifikimi i kryer nëpërmjet sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, pjesë e dosjes së hetimit.

⁵⁰ Dispozitivi i vendimit nr. ***, datë 16.12.2019: *Rrëzimin e kërkesëpadisë së paraqitur nga pala paditëse “****”sh.p.k. si të pabazuar në ligj e në prova. Në zbatim të nenit 40, pika 5 e ligjit nr. 49/2012 urdhërohet heqja e masës së sigurimit të padisë të marrë nga gjykata me vendim të ndërmjetëm të datës 7.8.2019. Në zbatim të nenit 45/a të ligjit nr. 49/2012 ky vendim është i paankimueshëm dhe i formës së prerë.*

formës së prerë e, për rrjedhojë, edhe gjykimi ose shqyrtimi i ankimit të veçantë të kërkuarit “Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë” duhet të pushohet, pasi ka mbetur efektivisht pa objekt, ashtu si edhe kërkesa për marrjen e masës së sigurimit të padisë”.

61.4 Sa më sipër, trupi gjykues nuk konstaton të dhëna për hetime të mëtejshme ndaj *indicieve* të marra nga burime të hapura, si dhe nuk vëren problematika lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

62. Në konkluzion përfundimtar, lidhur me kriterin e aftësive profesionale, trupi gjykues çmon se për subjektin e rivlerësimit Gentian Hamiti nuk janë konstatuar mangësi profesionale dhe, në këto kushte, referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, arrin në konkluzionin se subjekti arrin nivelin kualifikues të kërkuar neneve 44/a dhe 59/c të ligjit nr. 84/2016.

VLERËSIMI TËRËSOR

63. Në përfundim të vlerësimit të të tre komponentëve të rivlerësimit, trupi gjykues çmon të vlerësojë sjelljet e subjektit të rivlerësimit lidhur me pasurinë truall me sip. 300 m², blerë në vitin 2002, dhe shitur me akt përfundimtar shitjeje në shkurt të vitit 2008, e marrëdhënien e tij me shtetasin A. H. (djali i xhaxhait), veprime të trajtuara më lart në këtë vendim në mënyrë kronologjike e të hollësishme, duke i çmuar ato në raport me parashikimet ligjore të ligjit nr. 84/2016 për sjellje që cenojnë besimin e publikut tek drejtësia.

64. Nga vlerësimi i situatave në mënyrë të detajuar e të hollësishme rezultoi se subjekti i rivlerësimit në një moment të caktuar kohor, kur ai nuk ushtronte asnjë funksion publik, ka administruar, poseduar dhe disponuar një pasuri truall 300 m² në emrin e tij blerë në vlerën prej 215.000 (dyqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë nëpërmjet disa procedurave qartësisht ligjore, për të cilën nuk u konstatua asnjë situatë faktike abuzive apo që mund ta vendoste subjektin në ndonjë situatë ligjore penalizuese. Këtë pasuri, me veprime konkludente të kohës ai ka kërkuar ta shesë në shumën 800.000 (tetëqind mijë) lekë tek investitorët F dhe A. H. (vëllai dhe djali i xhaxhait). Për shkak të problemeve të pronësisë (të njohura botërisht në zonat ku zhvillohet ngjarja) marrëdhënia nuk u realizua e për shkak të ndryshimeve sociale e shoqërore në jetën e subjektit të rivlerësimit ai duhej të zhvendosej nga qyteti i lindjes, Delvina. Të gjitha këto rrethana duhen vlerësuar në raport me përcaktimet që ligji nr. 84.2016 ka bërë mbi cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, të cilat kanë në vetvete synim të vlerësojnë sjellje të subjektit të rivlerësimit gjatë ushtrimit të detyrës apo të lidhura ngushtësisht me të apo edhe element të integritetit të tij personal.

65. Nëse do të vlerësohet drejt kjo situatë, vijimësia e veprimeve të tjera deri në realizimin e shitjes së kësaj pasurie në shkurt të vitit 2008 përkundrejt vlerës 800.000 (tetëqind mijë) lekë, si dhe marrëdhënia e posaçme e subjektit të rivlerësimit (asaj kohe qytetar i Delvinës) me vëllain e tij F., mbizotëron qëndrimi/bindja se subjekti ka mbetur peng i një marrëdhënieje konfliktuale pronësie mes investitorëve dhe problemeve të shumta të pronësisë, të cilat nuk kanë lejuar tjetërsimin e pronës në kohën e pretenduar/dëshiruar nga subjekti i rivlerësimit, marrëdhënie e cila është zgjidhur përfundimisht vetëm në vitin 2008.

66. Trupi gjykues çmon se për sa i përket zbatimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, lidhur me indikator të matjes së etikës dhe integritetit për cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, si pasojë e veprimeve apo mosveprimeve të subjektit të rivlerësimit, në kohën kur ky i fundit nuk ushtronte funksione publike në sistemin e drejtësisë, nuk mund të merren në analizë në këndvështrim të parashikimeve të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016, pasi përbëjnë tejkalim të konceptit të “besimit të publikut te sistemi i drejtësisë”.

67. Cenimi i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, duhet të plotësojë disa elemente, si: *të ketë ndodhur për shkakun e pretenduar; të jetë i arsyeshëm e i konsiderueshëm apo i*

perceptueshëm; si dhe për shkelje të cilat nuk mund të kualifikohen si raste të tjera shkarkimi, të parashikuara në nenin 61, pikat 1, 2, 3 e 4 të ligjit nr. 84/2016.

68. Po ashtu, referuar jurisprudencës së Kolegjit, por edhe Gjykatës së Strasburgut, elementet e etikës duhet të përfshijnë sjelljen gjatë ushtrimit të detyrës, por edhe jashtë saj, e se këto elemente duhet të analizohen në raport me elementet e tjera të vlerësimit të kriterit profesional për të konkluduar më tej në zbatim të parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, efektin që ato do të kenë në konsiderimin e shkeljeve të kësaj natyre.

69. Pavarësisht se u evidentuan disa rrethana (fakte, ngjarje e të dhëna) që meritojnë të analizohen në kuadër të vlerësimit tërësor sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i udhëhequr nga parimi i proporcionalitetit dhe objektivitetit, i ndodhur para elementeve të tilla si: (i) një pjesë e konstatimeve i përkasin periudhës kur subjekti nuk ka ushtruar asnjë funksion publik apo edhe pak më vonë kur ai ushtronte detyrën e OPGJ-së; (ii) personat me të cilët ka kryer këto veprime rezultojnë të afërt familjarë me lidhje gjaku; (iii) mbi të gjitha nuk u evidentua që ushtrimi i funksionit të gjyqtarit të ketë ndikuar në ndonjë mënyrë apo rrethanë, apo anasjelltas të ketë ndikuar në ushtrimin e detyrës së tij, situata e rezultuar nuk është e mjaftueshme për të bërë të zbatueshëm aplikimin e nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016, për cenimin e besimit të publikut tek drejtësia.

70. Për një vlerësim objektiv të drejtë e proporcional të sjelljeve të subjektit, për arsye të mbrojtjes së interesit publik, i cili mund të kufizojë një të drejtë individuale apo cenojë interesa legjitime, duhet vlerësuar/peshuar problematika e konstatuar në raport të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë e, në mënyrë proporcionale, me qëllimin e ligjit nr. 84/2016, për një vendim të drejtë dhe proporcional procesi i rivlerësimit kalimtar duhet të jetë jo vetëm i paanshëm, objektiv dhe në përputhje me ligjin, por edhe i drejtë e i përshtatshëm në raport me funksionin/qëllimin e ligjit.

71. Në përfundim, trupi gjykues çmon se tërësia e sjelljeve të subjektit të rivlerësimit të rezultuara nga hetimi administrativ, të vlerësuara në raport të drejtë e proporcional me kërkesat dhe qëllimin e ligjit për rivlerësimin kalimtar, nuk përbëjnë shkak për aplikimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, duke çmuar se subjekti:

- ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- ka arritur një nivel të kënaqshëm kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale;
- nga vlerësimi tërësor nuk u konkludua se kishte veprime e sjellje të tilla që cenojnë besimin e publikut tek drejtësia; e

në bazë të nenit 58, pika 1, shkronja “a” dhe nenit 59, pika 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Gentian Hamiti, gjyqtar, aktualisht ushtron funksionin e tij si i komanduar pranë Gjykatës Administrative të Apelit.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
U shpall në Tiranë, në datën 19.3.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Olsi KOMICI
Kryesues

Valbona SANXHAKTARI
Relatore

Firdes SHULI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Elda Faruku